



Tiranë, më 18.04.2023



ANKIM

ANKUES: Partia Demokratike e Shqipërisë, me seli në adresën: Donika Kastrioti Nr.3, Tiranë, përfaqësuar nga **Indrit Sefa**, me email: indrit.sefa@gmail.com dhe nr.cel: (+355) 694060752.

OBJEKTI: SHFUQIZIMI I VENDIMIT NR. 361, DATË 15.04.2023 TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE PËR "MIRATIMIN E PËRMBAJTJES SË FLETËS SË VOTIMIT PËR KANDIDATËT PËR KËSHILLIN E BASHKISË TIRANË, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023".

SHFUQIZIMI I VENDIMIT NR. 362, DATË 15.04.2023 TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE PËR "MIRATIMIN E PËRMBAJTJES SË FLETËS SË VOTIMIT PËR KANDIDATËT PËR ANËTAR NË KËSHILLAT BASHKIAK NË 60 BASHKI PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023".

NDRYSHIMIN E PËRMBAJTJES SË FLETËS SË VOTIMIT DUKE VENDOSUR TË GJITHA KËRKESAT E PËRCAKTUARA NË NENIN 98 PIKA 3 E KODIT ZGJEDHOR SIPAS PROPOZIMIT BASHKËLIDHUR.

BAZA LIGJORE: Nenet 65 pika 3 dhe 98 pika 3, të Kodit Zgjedhor; Vendimi i Kolegjit Zgjedhor me Nr. 5 datë 04.04.2021 dhe Vendimi i KAS me Nr.19 datë 03.04.2021 dhe

DREJTUAR: KOMISIONIT TË ANKIMEVE DHE SANKSIONEVE PRANË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

PALË E INTERESUAR: KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Të nderuar anëtarë,

Me anë të Vendimit me Nr.179 datë 18.03.2023 Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendosi të regjistrojë Partinë Demokratike të Shqipërisë si subjekt zgjedhor.



Në mbledhjen publike të organizuar nga KSHZ në datën 15.04.2023 me anë të vendimit me Nr. 361 u vendos “MIRATIMIN E PËRMBAJTJES SË FLETËS SË VOTIMIT PËR KANDIDATËT PËR KËSHILLIN E BASHKISË TIRANË, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023” si dhe me anë të vendimit me Nr. 361 u vendos “MIRATIMIN E PËRMBAJTJES SË FLETËS SË VOTIMIT PËR KANDIDATËT PËR ANËTAR NË KËSHILLAT BASHKIAK NË 60 BASHKI, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023”

Duke qënë se kjo vendimarrje u mor në datën 15.04.2023 në orën 14.30 dhe duke qënë se ndaj këtij vendimi mund të bëhet ankim brënda 3 ditëve nga data e shpalljes së tij, po paraqesim këtë ankim pasi nuk jemi dakort me përmbajtjen e fletës së votimit dhe ajo do te duhet te ndryshohet ku në të përcaktohen qartësisht të gjitha të dhënat e kërkuara nga Kodi Zgjedhor në fuqi dhe më saktësisht neni 98 pika 3.

I. RRETHANAT E CËSHTJES

1. Partia Demokratike e Shqipërisë është regjistruar si parti politike me urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 12, datë 19.12.1990.
2. Presidenti i Republikës me anë të Dekretit me Nr. 13864, datë 24.10.2023 ka përcaktuar si datë për zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore datën 14 Maj 2023.
3. Me anë të Vendimit me Nr.179 datë 18.03.2023 Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendosi të regjistrojë Partinë Demokratike të Shqipërisë si subjekt zgjedhor.
4. Në datën 14.04.2023 me anë të emailit nga ana e administratës së KQZ na u dërguan disa variante në lidhje me përmbajtjen e Fletës së Votimit për kandidatët për anëtar për Këshillat Bashkiak të Tiranës dhe për 60 Bashki të tjera.
5. Në komunikimet tona në këto emaile kemi ngritur disa herë shqetësimin që nga ana e Komisionerit nuk ishin përcaktuar elementet e kërkuar në dispozitën e përcaktuar në nenin 98 pika 3 të Kodit Zgjedhor dhe disa nga elementët e detyrueshëm të kërkuar nga kjo dispozitë nuk ishin pasqyruar në këtë fletë votimi.
6. Komisioneri në seancë publike të datës 15.04.2023 pasi mori në shqyrtim dhe mori dhe opinionin e subjekteve zgjedhore të regjistruara vendosi për vendimin 361 datë 15.04.2023:



1. *Miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak, Bashkia Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas lidhjes që i bashkëlidhet këtij vendimi.*
2. *Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.*
3. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.*

Gjithashtu vendosi për vendimin 362 datë 15.04.2023

1. *Miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për anëtar në këshillat bashkiak, në 60 bashki për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas lidhjes që i bashkëlidhet këtij vendimi.*
2. *Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.*
3. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.*

7. Duke qënë se subjekti zgjedhor Partia Demokratike ka interes të ligjshëm në kundërshtimin dhe ankimin ndaj vendimeve të KSHZ pasi është regjistruar si pjesëmarrse në këto zgjedhje dhe është pjesë e Fletës së Votimit në të dyja këto vendimi atëhere është e detyruar për tu drejtuar me ankim në KAS duke kërkuar zbatimin e dispozitave ligjore dhe duke vendosur subjektet në kushte të barabarta garimi.

8. KSHZ me vendimarrjen e tij ka shkelur dispozitat e përcaktuara në nenin 98 pika 3 të Kodit Zgjedhor dhe gjithashtu ka mbajtur qëndrim kontradiktor me vendimarrjet e mëparshme të tijë dhe të KAS dhe Kolegjit Zgjedhor në përcaktimin e Fletës së Votimit për zgjedhjet e përgjishme të vitit 2021. Në përmbajtjen e kësaj Flete Votimi ka qënë e përcaktuar qartë emri i kryetarit të partisë drejtuese të Koalicionit.

9. Në mënyrë të pashpjegueshme dhe pa u mbështetur në asnjë dispozitë ligjore në këto zgjedhje KSHZ ka vendosur që mos të pasqyrojë këto të dhëna në Fletën e Votimit duke bërë të mundur diferencimin midis subjekteve zgjedhore dhe duke krijuar konfuzion te zgjedhësit për identifikimin e qartë dhe pa ekuivok të subjekte zgjedhore garuese në zgjedhje.

II. ANALIZA LIGJORE

10. Neni 98 pika 3 i Kodit Zgjedhor parashikon se: "3. Emrat e subjekteve zgjedhore vendosen në fletën e votimit, sipas rendit të përcaktuar në mënyrë të rastësishme nga shorti.



Përbri emrit të partisë vendoset sigla, shkronja nistore dhe emri i kryetarit të partisë. Çdo subjekti që renditet në fletën e votimit i korrespondon hapësira përkatëse për shënimin e votës nga zgjedhësi."

11. Nga përmbajtja e Fletës së Votimit për kandidatët për anëtar të Këshillave Bashkiak rezulton qartësisht se dy prej subjekteve zgjedhore pjesë e kësaj flete votimi të cilat janë koalicione nuk përmbushin përcaktimet ligjore të përcaktuara në dispozitën e sipërcituar. Më konkretisht 2 subjektët që i referohemi janë koalicioni Bashkë Fitojmë me shkronja nistore BF dhe Aleanca Liberale e Dhjathtë me shkronja nistore ALD. Në fletën e votimit për këtë subjekte mungon emri i kryetarit i cili do të duhet të shfaqej në fletën e votimit.

12. Në lidhje me hartimin e përmbajtjes së fletës së votimit kemi disa vendimarrje të mëparshme si nga ana e KAS ashtu dhe nga ana e Kolegjit Zgjedhor të cilët në vendimarrje të mëparshme kanë mbajtur qëndrime të konsoliduara në lidhje me elementët që do të duhet të përmbajë një fletë votimi.

13. KAS në vendimarrjen e tij me Nr.19 datë 03.04.2021 referon se: *"Gjithsesi, KAS-i shqyrtoi themelin e çështjes për t'i dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të palëve ankuese. Nga analiza ligjore e çështjes KAS-i konstaton se Kodi Zgjedhor ka vendosur hapësirë diskreciale për KQZ-në në çështjen e formatimit të fletës së votimit. Kjo hapësirë diskreciale bëhet e nevojshme për shkak se numri i subjekteve pjesëmarrëse mund të ndryshojë shumë nga një zgjedhje në tjetrën. Por Kodi, bashkë me diskrecionin, i ka caktuar KQZ-së kufij të pakapërcyeshëm dhe të palëvizshëm. Këto kufij kanë të bëjnë me:*

- *fleta e votimit duhet të jetë me ngjyrë dhe formë të njëjtë për të gjitha zonat zgjedhore (neni 97, pika 1);*
- *fletët e votimit duhet të jenë prej letre, me ngjyrë, trashësi ose elemente konfigurimi të tilla që të mos lejojnë leximin e votës në pjesën e pasme të saj, si dhe të përmbajnë elemente sigurie (neni 98, pika 1);*
- *emrat e subjekteve zgjedhore duhet të vendosen në fletën e votimit, sipas rendit të përcaktuar në mënyrë të rastësishme nga shorti. Përbri emrit të partisë duhet të vendoset sigla, shkronja nistore dhe emri i kryetarit të partisë (neni 98, pika 3);*
- *çdo subjekti që renditet në fletën e votimit duhet t'i korrespondojë hapësira përkatëse për shënimin e votës nga zgjedhësi (neni 98, pika 3).*
- *fleta e votimit për zgjedhjet për Kuvendin duhet të përmbajë hapësirën e posaçme për ushtrimin e votimit parapëlqyes për kandidatët e subjektit zgjedhor (neni 98, pika 4).*

4. E drejta e KQZ-së për të kompozuar informacionin e fletës së votimit, sidomos përsa i përket mënyrës së votimit parapëlqyes duhet të respektojë kushtet:

- *informacioni i përcjellë nga fleta e votimit të mos jetë tejte i ngarkuar;*



- konfigurimi i fletës të jetë i qartë e i kuptueshëm për zgjedhësin dhe
- zgjedhësi ta ketë të lehtë orientimin për votimin e subjektit zgjedhor dhe të kandidatit të parapëlqyer (neni 98, pika 4).

Ky është një detyrim ligjor i përcaktuar për KSHZ i cili do të duhet në të gjitha rastet të respektojë një vendimarrje të KAS i cili është lënë në fuqi nga Kolegji Zgjedhor. Në zbatim të kësaj vendimarrje KSHZ në hartimin e listave për zgjedhjet e përgjithshme të datës 25.04.2021 ka vendosur në përmbajtje të saj informacionin e kërkuar nga legjislatori dhe më konkretisht për koalicionin PD-AN (Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim) emirin e kryetarit të partisë udhëheqëse të koalicionit Z. Lulzim Basha si dhe të gjitha shkronjat nistore të partive përbërëse të koalicionit. Për të pasqyruar këtë pretendim po ju paraqesim si provë Fletën e Votimit për zgjedhjet e përgjithshme të datës 25.04.2021 ku ky informacion është pasqyruar saktësisht dhe i plotë.

14. Gjithashtu Kolegji Zgjedhor me anë të Vendimit me Nr. 5 datë 04.04.2021 në pikën 27 të tij referon se: *“Sa i përket pretendimit të paditësit për paligjshmërinë e vendimit nr.19, datë 3.4.2021 të KAS në lidhje me logon e Partisë Bindja Demokratike, të miratuar për t’u pasqyruar në fletën e votimit, Kolegji thekson se është i bazuar. Neni 98 pika 3 e Kodit Zgjedhor parashikon ndër të tjera se në fletën e votimit përbri emrit të partisë vendoset sigla (pra logo), shkronja nistore dhe emri i kryetarit të partisë. Kolegji vë në dukje se i njëjti rregull vlen dhe kur subjekti zgjedhor është koalicion, i cili kur regjistrohet, në kuptim të nenit 65 të Kodit Zgjedhor, duhet të deklarojë partinë politike udhëheqëse të tij, e cila për nevoja të zbatimit të këtij Kodi përmbush të gjitha të drejtat dhe detyrimet që përcakton Kodi për subjektet zgjedhore.”*

Ky shpjegim shterues i Kolegjit Zgjedhor do të duhet të gjente zbatim dhe në vendimarrjet e KSHZ i cili në mënyrë të pashpjegueshme ka vendosur që mos të zbatojë dispozitat e Kodit Zgjedhor duke krijuar në këtë mënyrë precedentë shumë të rrezikshëm në hartimin e akteve të tilla duke mos kërkuar zbatimin e ligjit por duke ja lënë në diskrecion të partive.

15. Me anë të kësaj vendimarrje Kolegji Zgjedhor i ka dhënë fund dhe pretendimit për legjitimitimin e këtyre kërtimeve nga ana e një subjekti tjetër për sa kohë që ka pranuar të shqyrtojë ankimin e PD-AN ndaj vendimit të KAS dhe KSHZ për sa i përket pretendimeve në lidhje me elementët e fletës së votimit që i takojnë një subjekti tjetër zgjedhor. Pra siç shihet nga këto vendimarrje subjekti zgjedhor Partia Demokratike ka të gjitha tagrat dhe të drejtat për të ngritur një ankim të tillë dhe për tu shqyrtuar në themel nga ana e KAS.

16. Për sa i përket faktit dhe pretendimeve të ngritura nga ana jonë, kjo vendimarrje krijon konfuzion të madh të zgjedhësit duke mos e qartësuar faktin se kush subjekte garajnë nën siglen e një koalicioni dhe kush është partia drejtuese e saj dhe rrjedhimisht kush është kryetari i partisë që drejton këtë koalicion. Më konkretisht



Koalicioni Bashkë Fitojmë me shkronja nistore BF drejtohet nga Partia e Lirisë me kryetar Ilir Metaj dhe kjo e përcaktuar qartësisht në marrëveshjen e koalicionit të datës 15.03.2023.

17. Në pikën 3 të kësaj Marrëveshje Koalicioni është përcaktuar qartësisht që partia udhëheqëse e këtij koalicioni është Partia e Lirisë si dhe në pikën 4 të kësaj marrëveshje përcaktohet qartësisht që i autorizuari i këtij koalicioni është Z. Ilir Metaj kryetar i Partisë së Lirisë. Përsëri në pikën 3 të kësaj marrëveshje është përcaktuar qartësisht dhe fakti që logo e koalicionit do të jetë ajo e referuar në këtë marrëveshje. Siç shihet gjatë aktiviteteve elektorale të zhvilluara nga ky subjekt zgjedorë dhe të kandidatëve të propozuar nga ky i fundit janë përdorur logo dhe emri i subjektit zgjedhor Partia Demokratike në kundërshtim flagrant me dispozitat e Kodit Zgjedhor.

18. KSHZ me anë të vendimarrjeve të tijë për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit të Kandidatëve për Anëtar të Këshillat Bashkiak nuk i ka dhënë zgjidhje kësaj problematike duke lejuar dhe duke shtuar më shumë paqartësinë e zgjedhësve për identifikimin e qartë të alternativës që do të votojnë dhe duke i krijuar konfuzion zgjedhëzve për të identifikuar qartësisht partitë pjesëmarrëse të këtij koalicioni dhe partinë drejtuese të tijë. Kjo vendimarrje përveçse është në kundërshtim me Kodin Zgjedhor ajo gjithashtu nuk ka respektuar vendimarrjet e mëparshme të KAS dhe Kolegjit Zgjedhor ndaj dhe KAS do të duhet të marri masa për të ndryshuar vendimarrjen e KSHZ.

19. Propozimi i Partisë Demokratike është që në Fletën e Votimit të vendoset emri i kryetarit të partisë udhëheqëse të koalicionit dhe gjithashtu dhe shkronjat nistore të subjekteve pjesëmarrëse në të. Për ta bërë sa më të qartë këtë kërkesë po i dërgojmë KAS dhe një model flete votimi sesi do të duhet të ishte miratuar nga ana e KSZ dhe si kërkon PD që të miratohet nga ana e KAS. Ndryshimi i vendimeve të KSHZ ai me Nr. 361 dhe 362 datë 15.04.2023 do të shërbente faktit që zgjedhësi ta ketë të lehtë orientimin për votimin e subjektit zgjedhor.

20. Gjithashtu përcaktimi i bërë në nenin 65 npika 3 e përcakton fare qartësisht se kush janë elementët që do të duhet të përmbajë marrëveshja e koalicionit që ajo të miratohet nga ana e KSHZ dhe më konkretisht: *“Në momentin e regjistrimit, koalicioni duhet të deklarojë partinë politike udhëheqëse të koalicionit. Për nevojat e zbatimit të këtij ligji, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton për subjektet zgjedhore përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit. Marrëdhëniet midis partive pjesëtare të koalicionit dhe detyrimet reciproke midis tyre rregullohen në marrëveshjen e koalicionit, e cila është pjesë e dokumentacionit që depozitohet nga koalicioni në KQZ”*



21. Për sa kohë që për të gjitha subjektet e tjera është e domosdoshme përcaktimi dhe vendosja e emërit të Kryetarit të Partisë në Fletën e Votimit e njëjta dispozitë do të duhet të zbatohet dhe për koalicionet zgjedhore dhe në referim të nenit 65 pika 3 referohet qartësisht që të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në Kodin Zgjedhor do të duhet të përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit që në këtë rast është Partia e Lirisë dhe Partia Balli Kombëtar Demokrat.

Për të gjitha sa më lart, bazuar në nenin Nenet 65 pika 3 dhe 98 pika 3, të Kodit Zgjedhor; Vendimi i Kolegjit Zgjedhor me Nr. 5 datë 04.04.2021 dhe Vendimi i KAS me Nr.19 datë 03.04.2021 dhe,

KËRKOJMË:

SHFUQIZIMI I VENDIMIT NR. 361, DATË 15.04.2023 TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE PËR "MIRATIMIN E PËRMBAJTJES SË FLETËS SË VOTIMIT PËR KANDIDATËT PËR KËSHILLIN E BASHKISË TIRANË, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023".


SHFUQIZIMI I VENDIMIT NR. 362, DATË 15.04.2023 TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE PËR "MIRATIMIN E PËRMBAJTJES SË FLETËS SË VOTIMIT PËR KANDIDATËT PËR ANËTAR NË KËSHILLAT BASHKIAK NË 60 BASHKI PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023".

NDRYSHIMIN E PËRMBAJTJES SË FLETËS SË VOTIMIT DUKE VENDOSUR TË GJITHA KËRKESAT E PËRCAKTUARA NË NENIN 98 PIKA 3 E KODIT ZGJEDHOR SIPAS PROPOZIMIT BASHKËLIDHUR.

ANKUES,

PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË

INDRIT SEFA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 15.4.2023

Nr: 362

Ora: 10:00

VENDIM

PËR

MIRATIMIN E PËRMBAJTJES SË FLETËS SË VOTIMIT PËR KANDIDATËT PËR ANËTAR NË
KËSHILLAT BASHKIAK NË 60 BASHKI PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE
TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot, më datë 15.4.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova çështjen,

OBJEKT: Miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për anëtarë në këshillat bashkiak në 60 bashki për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

BAZË LIGJORE: Neni 19, pikat 1, shkronja "n" e 2 dhe neni 98, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, vendimi nr. 8, datë 23.2.2023, të Komisionit Rregullator "Për procedurën e hedhjes së shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve në fletët e votimit, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore", të ndryshuar

VËREJ:


Komisioni Qendror i Zgjedhjeve brenda afateve të përcaktuara në nenin 67 pikat 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, ka regjistruar për të marrë pjesë në zgjedhjet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, listat e kandidatëve të partive dhe koalicioneve të regjistruara më parë si subjekte zgjedhore.

Me vendimin nr. 8, datë 23.2.2023, Komisioni Rregullator "Për procedurën e hedhjes së shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve në fletët e votimit, në

Data: 15.4.2023 Nr: 362
Ora: 10:30



"Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për anëtar në këshillat bashkiak në 60 bashki për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023."



zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, ka përcaktuar procedurën për hedhjen e shortit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbështetje të nenit 98, pika 3 dhe 4, duhet të miratojë përmbajtjen e fletës së votimit për subjektet zgjedhore që garojnë në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Në mbledhjen e datës 13.4.2023 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve organizoi shortin sipas procedurave të përcaktuara në vendimin nr. 8, datë 23.2.2023, të Komisionit Rregullator, dhe në përfundim të zhvillimit të shortit, u përcaktua renditja që do të kenë subjektet zgjedhore në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore. Renditja në fletën e votimit për kandidatët për këshillin e bashkisë do të bëhet sipas numrit rendor të dalë nga rezultati i shortit për subjektet zgjedhore të cilat kanë depozituar lista shumemërore.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, nenin 98, pika 3, 4 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimin nr. 8, datë 23.2.2023, të Komisionit Rregullator “Për procedurën e hedhjes së shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve në fletët e votimit, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”, të ndryshuar

VENDOS:

1. Miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për anëtar në këshillat bashkiak, në 60 bashki për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas lidhjes që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 15.4.2023 Nr: 362
Ora: 10:30



“Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për anëtar në këshillat bashkiak në 60 bashki për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.”

2




FLETË VOTIMI

Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore, 14 maj 2023

QARKU Tiranë
BASHKIA Tiranë

KANDIDATËT PËR KËSHILLIN E BASHKISË

1		BASHKË FITOJMË	
2		PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË	EDI RAMA
3		PARTIA AGRARE AMBJENTALISTE E SHQIPËRISË	AGRON DUKA
4		PARTIA REPUBLIKANE SHQIPTARE	FATMIR MEDIU
5		PARTIA LEVIZJA E LEGALITETIT	SHPËTIM AXHANI
6		PARTIA DEMOKRACIA SOCIALE	PASKAL MILO
7		ALEANCA LIBERALE E DJATHTË	
8		PARTIA SOCIALDEMOKRATE	TOM DOSHI
9		PARTIA DEMOKRATIKE	ENKELEJD ALIBEAJ
10		ALEANCA PROGRESISTE L.ZH.K	DASHAMIR SHEHI
11		FRYMA E RE DEMOKRATIKE	SALI SHEHU
12		PARTIA DREJTËSI, INTEGRIM DHE UNITET	SHPËTIM IDRIZI
17		ALEANCA ARBNORE KOMBËTARE	GJET NDOJ
18		PARTIA BALLI KOMBËTAR	ADRIATIK ALIMADHI
24		PARTIA KONSERVATORE	BASHKIM MURATI
35		NISMA THURJE	ENDRIT SHABANI
36		LËVIZJA BASHKË	ARLIND QORI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 15.4.2023

Nr: 361

Ora: 10:30

VENDIM

PËR

MIRATIMIN E PËRMBAJTJES SË FLETËS SË VOTIMIT PËR KANDIDATËT PËR KËSHILLIN E
BASHKISË TIRANË, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ
2023

Sot, më datë 15.4.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova çështjen,

OBJEKT:

Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak, Bashkia Tiranë për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

BAZË LIGJORE:

Neni 19, pikat 1, shkronja "n" e 2 dhe nenit 98, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, vendimit nr. 8, datë 23.2.2023, të Komisionit Rregullator "Për procedurën e hedhjes së shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve në fletët e votimit, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore", të ndryshuar.

VËREJ:


Komisioni Qendror i Zgjedhjeve brenda afateve të përcaktuara në nenin 67, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ka regjistruar për të marrë pjesë në zgjedhjet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, listat e kandidatëve të partive dhe koalicioneve të regjistruara më parë si subjekte zgjedhore.

Data: 15.4.2023 Nr: 361
Ora: 10:30



"Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për këshillin e bashkisë Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023".

1



Me vendimin nr. 8, datë 23.2.2023, Komisioni Rregullator "Për procedurën e hedhjes së shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve në fletët e votimit, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore", të ndryshuar, ka përcaktuar procedurën për hedhjen e shorti.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbështetje të nenit 98, pika 3 dhe 4, duhet të miratojë përmbajtjen e fletës së votimit për subjektet zgjedhore që garojnë në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Në mbledhjen e datës 13.4.2023, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve organizoi shortin sipas procedurave të përcaktuara në vendimin nr. 8, datë 23.2.2023, të Komisionit Rregullator dhe në përfundim të zhvillimit të shortit, u përcaktua renditja që do të kenë subjektet zgjedhore në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore. Renditja në fletën e votimit për kandidatët për këshillin e bashkisë do të bëhet sipas numrit rendor të dalë nga rezultati i shortit për subjektet zgjedhore të cilat kanë depozituar lista shumemërore.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja "n" e 2, nenin 98, pika 3 dhe 4 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, vendimit nr. 8, datë 23.2.2023, të Komisionit Rregullator "Për procedurën e hedhjes së shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve në fletët e votimit, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore", të ndryshuar.

VENDOS:

1. Miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak, Bashkia Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas lidhjes që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve


Ilirjan CELIBASHI

Data: 15.4.2023 Nr: 361
Ora: 10:30



"Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për këshillin e bashkisë Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023".

2





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDOR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI ANKIM E DHE
ISANKSIONEVE

Data: 03.04.2021

Nr: 19

VENDIM

PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE ANKIMORE NR. 08 TË PARTISË SOCIALISTE TË SHQIPËRISË, NR. 09 TË PARTISË BINDJA DEMOKRATIKE DHE NR. 10 TË KOALICIONIT PARTIA DEMOKRATIKE ALEANCA PËR NDRYSHIM (PD-AN) NDAJ VENDIMIT TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE NR. 198, DATË 01.04.2021

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve në mënyrë të bashkuar në datën 03.04.2021, më pas në anë të:

KolibeLE - Kryesues
Elvis ÇEFA - Anëtar
Elvin LAKO - Anëtar
Ilirjan RUSMALI - Anëtar
Ledio BRAHO - Anëtar

Shqyrtoi çështjen më:

Ankues 1: Partia Socialiste e Shqipërisë
Ankues 2: Partia Bindja Demokratike
Ankues 3: Koalicioni "Partia Demokratike Aleanca për Ndryshim" (PD-AN)


OBJEKT: Përshqyrtimin e kërkesave ankimore nr. 08 datë 01.04.2021, të Partisë Socialiste të Shqipërisë, nr. 09, datë 01.04.2021 të Partisë Bindja Demokratike dhe nr. 10, datë 02.04.2021 të koalicionit Partia Demokratike Aleanca për Ndryshim (PD-AN) më objekt të përbashkët "Ndryshimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 198, datë 01.04.2021 'Për miratimin e përmirësimit të fletëve të votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021'."

BAZË LIGJORE: Nenet 21, pika 1, shkronja "b"; 66; 98; 123/1; 124; 132 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhësor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar; nenet 19; 21; 30; 31 të Vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregulator "Për miratimin e rregullorës "Për mënyrën e



Data: 3 Prill 2021
Nr. 19, ora 11

Përshqyrtimin e kërkesave ankimore nr. 08, nr. 09 dhe nr. 10, ndaj vendimit të KSHZ nr. 198, datë 01.04.2021.



funksionin it dhe zhvillim it të seancave të Komisionit të Ankimin eve dhe Sanksioneve”.


Rrethanat e gështjes:

1. Presidenti i Republikës, nëm bështetje të neneve 65, pikat 1 dhe 2, 92 shkronja "gj", e 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të neneve 8, 9, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar, me Dekretin nr. 11700, datë 06.09.2020, ka caktuar datën 25 Prill 2021 për zhvillim in e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë.
2. Në përfundim të afatit për regjistrimin e listave shumë emërore në KQZ, janë regjistruar gjithsej dy koalicione zgjedhore, koalicioni me shkronja nistore (PD-AN) dhe koalicioni me shkronja nistore (ABEOK), 10 (dhjetë) parti politike, dhe 5 kandidatë të propozuar nga zgjedhësit.
3. Pas përfundimit të procesit të regjistrimit të listave shumë emërore, nëm bështetje të nenit 98, pika 5, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve organizoi hedhjen e shortit për detyrimet që rrjedhin nga ky nen. Me vendim in nr. 168, datë 18.03.2021, Komisioneri in itatoi rezultatin e shortit duke përcaktuar numrin rëndor që do të ketë çdo subjekt zgjedhormë fletën e votim it.
4. Rënditjanë fletën e votim it për kandidatët për deputet në 12 zonat zgjedhore do të bëhet sipas numrit rëndor të dalë nga rezultati i shortit për partitë politike të cilat kanë depozituar lista shumë emërore sipas materialeve bashkëlidhur këtij vendim in.
5. Në datën 31.3.2021, Komisioneri in vuri në lëvizje Komisionin Rregullator duke i propozuar shqyrtim in dhe m in itatin in e projektvendim it "Për m in itatin in e pëmbajtjes së fletëve të votim it për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021". Komisioni Rregullator nëm bledhjen e tij të datës 31.3.2021, vendosi m ungesën e kompetencës për shqyrtim in e këtij projektvendim it.
6. Në datë 01.04.2021 Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendim in nr. 198, vendosi m in itatin in e fletëve të votim it për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill, 2021 në formatin landscape, duke përshatur sipas numrit të kandidatëve, m adhepsinë e fontit dhe stilizim ete logove për çdo qark.
7. Kundërvendim it të Komisionit nr. 198, datë 01.04.2021 kabërë ankim in subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, duke parashtruar se pëmbajtja dhe konfigurim in i fletës së votim it in ituar nga KSHZ konstatohet m en një numër të lartë të emrave të kandidatëve dhe rrjedhimisht sjell një vështitësi substanciale në procesin e përzgjedhjes së kandidatit apo subjektit të preferuar. Votuesi do e ketë të vështitë orientim in në fletë nëm ënyrë që shënim in e fletën e votim it të korrespondojmë me kandidatin që ai dëshiron që të jetë përfaqësuesi i tij në Kuvend. Ankuesi pretendon se varianti in ituar i fletës së votim it krijon një gjendje



Data: 3 Prill 2021
Nr. 19, ora 11


Përshqyrtim in e kërkesave ankim ore nr.08, nr.09 dhe nr.10, ndaj vendim it të KSHZ nr.198, datë 01.04.2021



pabarazie të votuesve në zonat zgjedhore apo qarqe të ndryshme. Varianti i fletës së votim it të miratuar vjen në kundërshtim me vendimin nr. 168, datë 18.03.2021 "Për miratimin e rezultatit të shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore në fletën e votim it për zgjedhjet për Kurvend të datës 25 Prill 2021" të KSHZ-së, i cili ka marrë formë të përcaktuar nga asnjë palë e interesuar. Për subjektin ankues, varianti i fletës me numra është varianti më i përshtatshëm sepse duke marrë në konsideratë situatën aktuale, është më e qartë dhe e thjeshtë për votuesin kur të paraqitet në dhomën e fshhtë. Fleta e votim it me numra është në përputhje me vendimin nr. 168, datë 18.03.2021 të KSHZ-së, pasi emrat e subjekteve zgjedhore janë të konfiguruar në përputhje me konfigurimin e tyre në këtë vendim. Për pasojë, sipas PS, vendimi nr. 198, datë 01.04.2021 i KSHZ-së duhet të ndryshohet dhe të miratohet fleta e votim it për 12 qarqet e Republikës së Shqipërisë sipas variantit të paraqitur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), ku në përmbajtje të saj, kandidatët të identifikohen me numra.

8. Kundërvendim it të Komisionerit nr. 198, datë 01.04.2021 ka bërë ankim subjekti zgjedhor Partia Binda Demokratike, duke parashtruar se pasqyrohet në faqen zyrtare të KQZ-së fleta e votim it ku si sigël e Partisë Bindja Demokratike ishte një sigël që nuk ka lidhje me siglën tonë të ristilizuar, dhe që nuk është dërguar nga subjekti ankues. Për këtë arsye, subjekti ankues Partia Bindja Demokratike kërkon pasqyrimin e siglës që është paraqitur nga vetë subjekti në penggjyqje të shkresës nr. 3010 prot. të KSHZ-së.
9. Kundërvendim it të Komisionerit nr. 198, datë 01.04.2021 ka bërë ankim koalicioni "Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim" (PD-AN), duke parashtruar se versioni i fletës së votim it miratuar nga KSHZ-ja vjen në kundërshtim me kriterin e qartësisë që parashikon nenin 98, pika 4 e Kodit Zgjedhor. Versioni i propozuar nga KSHZ në mbledhjen e datës 31.03.2021, drejtuar Komisionit Rregullator, më po të njëjtën përmbajtje por me orientimin "portrait" dhe jo "landscape" (si dhe u miratua) është më i qartë dhe i kuptueshëm për zgjedhësit. Gjithashtu, nga një sondazh që KQZ ka bërë në faqen e saj zyrtare për të gjitha modelet e fletëve të votim it, fleta e votim it e cila përshkruan kandidatët me emra por me orientimin "portrait" është ajo që ka marrë më shumë vota nga votuesit (79%). Së dyti, subjekti ankues pretendon se emblema e subjektit zgjedhor Bindja Demokratike është shumë e ngjashme dhe krijon konfuzion dhe lajthitje të votuesve me emblemen e subjektit zgjedhor koalicionit "Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim" (PD-AN). Duke konsideruar se emri i koalicionit dhe sigla përkatëse janë historike dhe figurojnë të tilla në të gjitha proceset zgjedhore pas vitit 1991, më bështetur në nenin 66 të Kodit Zgjedhor, subjekti kërkon marrjen e asave përkatëse. Për këtë arsye, subjekti ankues kërkon ndryshim në vendim nr. 198, datë 01.04.2021 të KSHZ-së vetëm për pjesën që disponon me orientimin "landscape" dhe jo "portrait" të fletës së votim it, dhe mbledhjen e përdorim it të fletës së votim it pa llogon e subjektit Bindja Demokratike.
10. Ankim et i paraqitur nga KAS-it, i cili caktoi nga një rektor për secilin prej tyre, z. Koli Bëlle për kërkesën ankimore nr.8; z. Elvin Lako për kërkesën ankimore nr.9 dhe z. Ledio Bëlle për kërkesën ankimore nr.10.





Në seancën përgatitore të datës 02.04.2021 KAS-i vendosi pranimin in për shqyrtimin të kërkesave ankim oie dhe bashkim in e tyre në një çështje të vetme e relator z. KoliBekë. KAS-i caktoi seancën e shqyrtimit in në datën 03.04.2021, ora 11.00.

11. KAS-im orinë shqyrtim dhe adm inistroi:


- vendim in nr.198, datë 01.04.2021 të Kom isionerit Shtetëor të Zgjedhjeve;
- procesverbalin e mbledhjes së Kom isionerit Shtetëor të Zgjedhjeve për m anjen e vendim in nr.198, datë 01.04.2021;
- versionet e fletëve të votim in të përgatitura nga adm inistrata e KQ Z-së sipas variantim e num ra për 12 qarqet;
- shkresë nr.3003 prot., datë 31.03.2021 e koalicionit "Partia Dem okratike-A leanca për N dryshim " (PD - AN);
- shkresën nr.3010/A, datë 01.04.2021 e Partisë B indja Dem okratike.

Në përfundim të shqyrtim in adm inistrativ dhe të vlerësim in të provave dhe pretendim eve të palëve,

KAS-i konstatoi:

1. Komisioni Rregullator ka vendosur moskompetencën për lëndën e miratimit të përmbajtjes së fletës së votimit. Kundër këtij vendimi nuk është bërë ankim nga asnjëri prej subjekteve zgjedhore. Përkundrazi, palët kanë pranuar dhe kanë marrë pjesë aktive në procedurën vijuese që Komisioneri zhvilloi në zbatim të vendimit të Rregullatorit. KAS-i çmon se miratimi i përmbajtjes së fletës së votimit është pjesë e lëndës rregullore të zgjedhjeve, për pasojë përfshihet në kompetencën e shprehur të Rregullatorit për të m inatuar "rregullat e detajuara për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve, detyrat e administratës zgjedhore dhe procedurat që zbatohen në zgjedhje (pika 1 e nenit 20 të KZ). KAS vlerëson se kompetenca rregullore për zgjedhjet është kompetencë ekskluzive e Rregullatorit dhe nuk mund të ushtrohet as nga Komisioneri, as nga KAS-i. Ky vlerësim mbështetet edhe në praktikën institucionale të vetë Rregullatorit, i cili mbi të njejtën bazë ligjore ka miratuar specifikimet teknike të fletës së votimit. KAS-i i qendron vlerësimit se miratimi i fletës së votimit është kompetencë rregullore, e cila duhet të ushtrohet nga Rregullatori. Nga ana tjetër, KAS-i është i detyruar të konstatojë dhe pranojë faktin se kundër vendimit nr.12, datë 31.3.2021 për shpalljen e moskompetencës nga Rregullatori nuk ka bërë ankim asnjëra nga palët. Mungesa e ankimit specifik e bën vendimin e Rregullatorit detyrues për Komisionerin, i cili nga ana e tij nuk mund të shpallte moskompetencën, sa kohë që një akt me fuqi detyruese e ngarkonte me miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit. Mbi të njejtin arsyetim ligjor, KAS-i nuk mund të konstatojë pavlefshmërinë e vendimit të Komisionerit nr.198, datë 1.4.2021, sa kohë që





vendimi ka dalë në bazë të një akti të Rregullatorit, i cili është në fuqi. KAS-i është i detyruar të shqyrtojë dhe zgjidhë në themel ankesën.

2. Në vendimin e tij nr.6, datë 26.2.2021 Komisioni Rregullator ka miratuar specifikimet teknike të fletës së votimit. Në rrethin e specifikimeve teknike bën pjesë edhe përcaktimi i përmasave të fletës së votimit. Sipas shtojcës së vendimit të sipërcituar, përmasat e fletës së votimit për zgjedhjet e datës 25.04.2021 do të jenë: gjerësia 297mm dhe gjatësia 420mm. Ky vendim është detyrues për Komisionerin si dhe për KAS për sa i përket përmasave të fletës . Miratimi i fletës së votimit me përmasa të ndryshme nga ato të miratuara me vendimin e Rregullatorit të sipërcituar përbën shkelje, e cila në vetvete përbën shkak ligjor për shfuqizimin e vendimit të Komisionerit nr. 198, datë 01.04.2021.

3. Gjithsesi, KAS-i shqyrtoi themelin e çështjes për t'i dhënë përgjigje të gjitha pretendimëve të palëve ankuese. Nga analiza ligjore e çështjes KAS-i konstaton se Kodi Zgjedhor ka vendosur hapësirë diskreciale për KQZ-në në çështjen e formatimit të fletës së votimit. Kjo hapësirë diskreciale bëhet e nevojshme për shkak se numri i subjekteve pjesëmarrëse mund të ndryshojë shumë nga një zgjedhje në tjetrën. Por Kodi, bashkë me diskrecionin, i ka caktuar KQZ-së kufij të pakapërcyeshëm dhe të palëvizshëm. Këto kufij kanë të bëjnë me:

- fleta e votimit duhet të jetë me ngjyrë dhe formë të njëjtë për të gjitha zonat zgjedhore (neni 97, pika 1);
- fletët e votimit duhet të jenë prej letre, me ngjyrë, trashësi ose elemente konfigurimi të tilla që të mos lejojnë leximin e votës në pjesën e pasme të saj, si dhe të përmbajnë elemente sigurie (neni 98, pika 1);
- emrat e subjekteve zgjedhore duhet të vendosen në fletën e votimit, sipas rendit të përcaktuar në mënyrë të rastësishme nga shorti. Përbri emrit të partisë duhet të vendoset sigla, shkronja nistore dhe emri i kryetarit të partisë (neni 98, pika 3);
- çdo subjekti që renditet në fletën e votimit duhet t'i korrespondojë hapësira përkatëse për shënimin e votës nga zgjedhësi (neni 98, pika 3).
- fleta e votimit për zgjedhjet për Kuvendin duhet të përmbajë hapësirën e posaçme për ushtrimin e votimit parapëlqyes për kandidatët e subjektit zgjedhor (neni 98, pika 4).

4. E drejta e KQZ-së për të kompozuar informacionin e fletës së votimit, sidomos për sa i përket mënyrës së votimit parapëlqyes duhet të respektojë kushtet:

- informacioni i përcjellë nga fleta e votimit të mos jetë tejet i ngarkuar;
- konfigurimi i fletës të jetë i qartë e i kuptueshëm për zgjedhësin dhe



The first part of the document discusses the importance of maintaining accurate records of all transactions. It emphasizes that every entry should be supported by a valid receipt or invoice. This ensures transparency and allows for easy verification of the data.

In the second section, the author outlines the various methods used to collect and analyze the data. This includes both primary and secondary data collection techniques. The analysis focuses on identifying trends and patterns over time.

The third section provides a detailed breakdown of the results. It shows that there has been a significant increase in sales volume over the past year, particularly in the online channel. This is attributed to several factors, including improved marketing strategies and a more user-friendly website.

Finally, the document concludes with a series of recommendations for future actions. It suggests that the company should continue to invest in digital marketing and explore new product lines to further expand its market reach.


- zgjedhësi ta ketë të lehtë orientimin për votimin e subjektit zgjedhor dhe të kandidatit të parapëlqyer (neni 98, pika 4).

Form ulim i pikës 4 të nenit 98 të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, nënkupton se KQZ -ja ka të drejtën ligjore të zgjedhë sasinë e informacionit për votim in parapëlqyes që do të përfshijë në fletën e votim it, në varësi nga nevoja për ta mbajtur fletën e votim it të thjeshtë, me konfigurim të qartë e të kuptueshëm dhe me orientim të lehtë. Nëse informacioni për votim in parapëlqyes është i ngarkuar, atëherë KQZ -ja është e detyruar të thjeshtojë informacionin, deri në minimumin e mundur për votim . Fleta e votim it, me emrat e kandidatëve të listës, me numrin rëndor përmbri dhe me hapësirën për votim parapëlqyese përmben maksimumin e mundur të informacionit që mund të përfshihet në fletën e votim it për kandidatët. Thjeshtimi, dhe lehtësimi nënkuptojnë zgjedhje që janë më pak se kaq. Lehtësimi do të thotë heqja e emrave të kandidatëve nga fleta e votim it (e pjesshme ose e plotë). Thjeshtimi do të thotë unifikimi i hapësirës për votim me hapësirën e numrit rëndor, e ndjekur nga disa alternativa përmbri e votim it.

5. Sa i përket kompozim it të fletës së votim it, interesi i zgjedhësve është interesim adhor në raportim e interesin e subjekteve zgjedhore dhe të kandidatëve të tyre. Fleta e votim it nuk është në shërbim të subjekteve dhe kandidatëve, por është në shërbim të drejtpërdrejtë të zgjedhësve. Përmbi tepër, kompozimi i saj ka ndikim të drejtpërdrejtë tek lehtësimi i procedurave të votim it e të numërimit të votave, tek ruajtja e fshehtësisë së votim it, si dhe tek ulja e rasteve të pavlefshmërisë apo të votim it të gabuar. Interesat e subjekteve dhe të kandidatëve të tyre nuk janë domosdoshmërisht në harmoni me interesin e votuesve në këtë pikë. Preferencat e tyre mund të shkojnë drejt pozicionit it të subjektit në fillim apo në fund të fletës së votim it, për të përfituar nga lehtësia në votim , mund të jenë për një fletë votim im e përmbi asatë m'edha, e cila mundëson "leximin" e votës nëpërmbi pozicionin it dhe lëvizjeve trupore që bëjnë votuesi kur voton në fillim të një flete të m'adhe, apo kur voton në fund të saj, mund të jenë për zgjedhjen në kohë të procesit të votim it, me qëllim që procesit të zvarritet dhe eventualisht një pjesë e votuesve të mbeten pa votuar, sikurse mund të jenë për vështirësimin e votim it, me qëllim që pavlefshmëria në votim të jetë e lartë. Asnjë nga këto preferenca, në rastin konkret nuk nënkupton se subjekti është i motivuar nga keqdashja apo keqbesimi, por KQZ -ja duhet të kujdeset apriori që vendimarrja e saj të mos lehtësojë apo favorizojë keqdashjen ose keqbesimin. Për këtë arsye, KQZ -ja nuk mund të vendosë si objektv konsensusin publik apo mbidis subjekteve zgjedhore kur kompozon fletën e votim it, por duhet të kujdeset që të plotësojë pa kompromis nevojat e votuesve për fletë votim it të thjeshtë, të qartë, të kuptueshme dhe të lehtë në orientim .

6. Praktikave vendeve të tjara që përdorin mbri enyra të ngjashme e votim it kanë shkuar drejt respektimit it të nevojave të zgjedhësve dhe jo të kërkesave të subjekteve. Në Itali, fleta e votim it përmbi ban si informacion vetëm emrat e udhëheqësve të listës (dy, tre apo katër), por jo listën e plotë të kandidatëve. Në Kosovë votim iparapëlqyes bëhet mbri binumra, informacioni konsondues për kandidatët jepet mbri bollëk mbrienda mbri jediseve të qendrës së votim it, por jo në fletën e votim it. Emrat e kandidatëve të listës janë pjesë e fletës





së votim it vetëm në praktikën e votim it në Greqi, por m odeli grek është i papajueshëm ligjrisht m e m odelin tonë të votim it.

7. Përfshirja e njëqind për qind të inform acionit për kandidatët në fletën e votim it, sikurse është bërë nga Kom isionerim e vendim in nr:198, datë 1 4 2021, ka mitur pë m asën e fletës së votim it. Përveç argum entit ligjor të trajtuar m ë sipër, ky fakt përbën shqetësim real për procesin e votim it, sepse pë m asa e ekstem ishtem edhe e fletës së votim it vështirëson përdorim in e saj pë ngjate procesit të votim it, nezikon tejn bushjen e kutive për shkak të m adhësisë së fletës, kom piron enton fishehtësinë e votim it, ngarkon adm inistrim in pë ngjate num ërim it të votave, si dhe mtpotencialim anipulativ në num ërim , vecanërisht për votëtpara pë lkyesë të kandidatit. Përpos këtyre neziqeve evidente, m odeli im i riatur m ekëto pë m asa m it në m ënyrë të pajustificueshëm e koston e piodhim it të tyre. Kom isioneri duhet të kishte analizuar, eksperim entuardhe zgjidhur pozitivishtelim inim in e këtyre neziqeve të procesit, pë rpara se të m iatonte këtë fletë votim i.

8. Zgjidhja e dhënë për zvogëlim in e m adhësisë së fontit, m e qëllim që të sistam ohen brenda fletës së votim it en rate të gjithë kandidatëve që garojnë në zonën zgjedhore shkon dy herë në dëm të zgjedhësve, një herë për shkak të zvogëlim it të gë m ë s, të dytën për shkak të tejn bushjasm e inform acion.


9. Kodi zgjedhor kërkon në m ënyrë taksative që fletët e votim it të kenë të njëjën ngjyrë dhe të njëjën fom ë në të gjitha zonat zgjedhore. Por Kodi nuk kërkon që fletët e votim it të kenë të njëjën pë m asë dhe të njëjën pë m bajtje në të gjitha zonat. Kom isioneri m und të kishte m anë në konsideratë këtë hapësi të ligjore dhe t'i kishte rekom anduar R egullatorit që të adoptonte zgjidhje alternative nganjë zonë në tjetrën, për të pajuar kërkesat e subjekteve m e nevojën për të m bajur fletën e votim it të thjeshtë, të qartë, të kuptueshëm e dhe të lehtë në orientim . N jë gjë e tillë m und të realizohej p sh. m e fletën e votim it në Kukës, ku garojnë 12 subjekte dhe 36 kandidatë, e cila krijon m undësi kërjësish të tjera krahasuar m e fletën e votim it në Tiranë, ku garojnë 13 subjekte dhe 433 kandidatë.

10. Përtej arsytim it parim or, KAS -i këqyrim odekte fletës së votim it që u ishin prezantuar R egullatorit dhe Kom isionerit dhe qm on se, m idis tyre, kërkesat ligjore i pbtëson m ë m irë fleta e votim it që i bashkëlidhet këtij vendim i.

11. Lidhur m ekërkesën ankim ore të subjektit B indja D em okratike (BD) dhe kërkesën m e të njëjin objekt të koalicionit Partia D em okratike -A leanca për N dryshim (PD -AN), KAS -i konstaton se arsytim i i Kom isionerit se subjekti BD duhet të ndryshojë logon m e të cilën paraqitet në fletën e votim it, nuk gjen m bështetje në ligj. Në shqyrtim in e kontestim eve të kësaj natyre, Kom isioneri duhet të m ente në konsideratë, të gjykonte dhe të vendoste:

- nëse logot janë të ngjashme në atë masë që mund të shkaktojnë konfuzion tek zgjedhësi;
- cili nga subjektet ka të drejtën të marrë lgon dhe cilit duhet t'i kërkohet të depozitojë një logo të re.






Komisioneri nuk e ka tagrin që të caktojë a in një logo të re për subjektin, kundërvulhetit të këtij të fundit, sidomos nuk ka të drejtë që të kushtëzojë vendim arrijn e tij me miratimin nga njëri apo tjetri subjekt. Neni 66 i Kodit Zgjedhor përcakton se për të caktuar precedencën në përzgjedhjen e logos KQZ -ja merr në konsideratë "datën e themelimit të ligjrit të partive ose datën e regjistrimit të partitë të koalicionit në KQZ". Për të përcaktuar datën e partitë të regjistrimit të koalicioneve, KQZ -ja i referohet edhe zgjedhjeve të mëparshme". Subjekti zgjedhor BD ka datë të themelimit të ligjrit datën 25.4.2019, në të cilën Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e ka regjistruar si person juridik. Koalicioni zgjedhor PD -AN është regjistruar në zgjedhje për herë të parë më datë 23.2.2021, më vendim in e Komisionerit nr.107, s bashkimit 13 partive politike. KAS-i konstaton se datam e themelimit të subjektit BD, në kuptim të regjistrimit të subjektit zgjedhor gamës në këto zgjedhje, i jep atij precedencën sipas nenit 66 të Kodit. Pavarësisht nga kjo, KAS-i qm on se këqyrja e fletës së votimit, në të gjitha mënyrat e përgatitua nga administrata e KQZ -eë, përfshirë të dhënat për emërtimin dhe sigllën e subjektit, emrin e kryetarit të partitë, logon dhe pozicionin in e subjekteve larg njëri tjetrit në fletën e votimit çon në përfundim in se nuk ka shkakë ligjore dhe faktike për të ham endësuar konfundim in e zgjedhësve për shkak të logove të subjekteve BD dhe PD -AN.

12. Vlen të theksohet se subjekti ankues BD, më kërkese të Komisionerit ka pranuar të ndryshojë logon e partitë të depozituar fillim inisht për këtë proces zgjedhor, duke ristilizuar logon më qëllim përfshirjen e elementeve që e bëjnë të dallueshmë atë. Konkretisht, nga pikëpamja vizuale dhe fonetike, në variantin e ristilizuar kam ipasqyrim in e emrit (B in dja D in okratike) e cila dallon nga logo e partitë e depozituar që kishte vetëm shkronjat nistore të inkuadruara në simbolin/logo. Po ashtu edhe nga pikëpamja konceptuale, tek logo e ristilizuar kam in ndryshim e (psh: ngjyra më e çelur) që e bëjnë akoma më të theksuar dallim in më logon e subjektit PD -AN. Pretendim in i ankuesit PD -AN, se në mospërim të logos se vendosur (ndryshuar) nga Komisioneri, në alternativë, logo e subjektit DB duhet të hiqet nga fleta, duke gamarvetem më emër, është ipabazuar në nenin 66 të Kodit Zgjedhor sidhe parim etepërgjithshëm e kushtetuese e ligjore që garantojnë barazinë e palëve në procesin zgjedhor, duke përfshirë të drejtën të identifikohen më një logo të zgjedhur prej tyre.

13. Po ashtu pretendim ete subjektit zgjedhor PD -AN, lidhur më ndryshim in e vendim in të Komisionerit, duke miratuar një fletë të njëjtë në përmbajtje në orientim in portrait dhe jo landscape, për sa kusyhet më sipër, nuk gjejnë më bështetje në ligj dhe prova dhe sitë tilla nuk më und të pranohen nga KAS.





PËR KËTO ARSYE :


Për të gjitha arsyet e shtjelluara më sipër dhe më bështetur në nenet 21, pika 1 shkronja 'b', të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe më bështetur në shkronjën 'b' të pikës 1 të nenit 30 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 të Komisionit Regulator, në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, më shumë votash, KAS-i,

V E N D O S I:

1. Ndryshimin e vendimit nr.198, datë 01.04.2021 të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për miratimin e pëmbajtjes së fletëve të votimit për zgjedhjet për kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021";
2. Pranimin e kërkesës ankimore nr. 08, datë 01.04.2021 të paraqitur nga Partia Socialiste e Shqipërisë;
3. Miratimin e fletës së votimit sipas modelit bashkëlidhur këtij vendim;
4. Pranimin e kërkesës ankimore nr. 09, datë 01.04.2021 të paraqitur nga Partia Bindja Demokratike, duke vendosur në pëmbajtje të fletës së votimit logon e ristilizuar të depozituar nga ky subjekt;
5. Rezimin e kërkesës ankimore nr. 10, datë 02.04.2021 të paraqitur nga Koalicioni Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim;
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
7. Kundërkëtëj vendim imund të bërhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit, Tiranë brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Koli BELE	-	Kryesues
Elvin LAKO	-	Anëtar
Elvis ÇEFA	-	Anëtar (Kundër)
Ilirjan RUSMALI	-	Anëtar
Ledio BRAHO	-	Anëtar (Kundër)





MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin e kërkesave ankimore nr. 8, 9 dhe 10, respektivisht subjekteve zgjedhore Partia Socialiste e Shqipërisë, Partia Bindja Demokratike dhe Koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim me objekt të përbashkët "Ndryshimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 198, datë 01.04.2021 "Për miratimin e përmbajtjes së fletëve të votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021" (në vijim vendim i nr. 198, datë 01.04.2021), të paraqitura në KQZ në datat 01.04.2021 (kërkesat ankimore nr. 8 dhe 9) dhe 02.04.2021 (kërkesa ankimore nr. 10), jemi kundër vendimit të shumicës për pranimin e ankimit të subjekteve zgjedhore Partia Socialiste e Shqipërisë dhe Partia Bindja Demokratike dhe kemi mendim paralel në raport me vlerësimin dhe arsyetimin e përdorur nga shumica në lidhje me rrëzimin e ankimit të subjektit zgjedhor Koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim. Ne, anëtarët në pakicë, vlerësojmë se Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve (në vijim KAS) duhet të rrëzonte të tre kërkesat ankimore, ndaj ju paraqesim, në vijim, argumentet tona për këtë qëndrim.


2. Si fillim sqarojmë se pjesë e këtij shqyrtimi administrativ kanë qenë tre ankime:

- ankim i depozituar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, që kundërshtonte vendimin nr. 198, datë 01.04.2021 dhe që kërkonte miratimin e fletës së votimit për 12 qarqet e Republikës së Shqipërisë për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021 sipas variantit ku në përmbajtjen e fletës së votimit kandidatët të identifikohen me numra;
- ankim i depozituar nga subjekti zgjedhor Partia Bindja Demokratike që kundërshtonte vendimin nr. 198, datë 01.04.2021 dhe që kërkonte miratimin e fletës së votimit për 12 qarqet e Republikës së Shqipërisë për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021 sipas variantit ku në përmbajtje të fletës së votimit të jetë stema e ristilizuar e Bindjes Demokratike në KQZ me shkresën 3010/1, datë 01.04.2021, ora 15:50; dhe
- ankim i depozituar nga subjekti zgjedhor Koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim që kundërshtonte vendimin nr. 198, datë 01.04.2021 dhe që kërkonte të njëjtën fletë votimi si ajo e miratuar me vendimin e kundërshtuar, por me orientim të ndryshëm, nga *landscape në portrait* (nga horizontal në vertikal) si dhe në miratimin e fletës së votimit pa logo të subjektit zgjedhor Partia Bindja Demokratike.

Bashkim i kërkesave ankimore është bërë me vendim të KAS, në zbatim të nenit 65 shkronja "ç" të K.Pr.Administrative¹ meqenëse kërkesat ankimore bazohen në të njëjtat fakte dhe bazë ligjore



¹ "Në fillim të procedurës administrative, organi publik kryen verifikimin ete m'eposhtun e: ... ç) nëse kërkesa e një pale për fillimin e një procedure administrative mund të shqyrtohen së bashku me kërkesat e palëve të tjera, nëse bazohet në të njëjtat fakte dhe bazë ligjore".



e për më tepër që janë ndaj të njëjtit vendim² të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Pas vendimmarrjes për pranim për shqyrtim të të tre kërkesave ankimore në zbatim neneve 130 dhe 131 të K.Zgjedhor si dhe nenit 18 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve "Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimave dhe Sanksioneve", është zhvilluar sënca për shqyrtimin e të tre kërkesave ankimore.

3. Shumica, në hyrje të vendimit të saj arsyeton çështjen e kompetencës së Komisionit Rregullator në raport me miratimin e fletës së votimit duke përfshirë specifikimet teknike të saj, por dhe përmbajtjen e fletës së votimit. Sipas shumicës, pavarësisht se Komisioni Rregullator, me anë të vendimit nr. 12, datë 31.03.2021 "Për shpalljen e moskompetencës së Komisionit Rregullator për shqyrtimin e projektvendimit për miratimin e përmbajtjes së fletëve të votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021", me unanimitet ka shpallur moskompetencën në lidhje me përmbajtjen e fletës së votimit, gjen me vend të arsyetojë se kjo kompetencë është ekskluzive e këtij organi kolegjal të KQZ. Është e paqartë se përse KAS duhet të përfshihet dhe të gjykojë një konflikt të supozuar kompetencash mes dy organeve të tjera të KQZ. Më tej shumica citon vendimin nr. 26, datë 26.12.2021 të Komisionit Rregullator "Për miratimin e specifikimeve teknike të fletës së votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021" ku në pikën 2 të dispozitivit të këtij vendimi citohet se "Komisioni Rregullator, mund të ndryshojë përmasat e fletës së votimit, në varësi të listave shumëmërore për çdo zonë zgjedhore". Pavarësisht shpalljes së mungesës së kompetencës së Komisionit Rregullator me vendimin e sipërcituar të datës 31.03.2021, në procesverbalin e zbardhur të mbledhjes së këtij komisioni në datë 26.02.2021, kur kanë miratuar dhe specifikimet teknike të fletës së votimit, dukej se të gjithë anëtarët kishin qasjen se ishte Komisioni Rregullator kompetent për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit. Më konkretisht, shkëpusim nga procesverbali deklarimet si vijojnë:

"Znj. H. Vukaj: ... do doja të shprehja diçka në lidhje me aktin meqenëse ka pasur pritshmëri të madhe mediatike dhe nga publiku për hir të debatit të paraçelur në media qoftë nga forcat politike apo nga grupet e interesit. Akti i sotëm është shumë i rëndësishëm sepse çel siparin e prokurimit të fletës së votimit e cila në vazhdimësinë e saj dhe elementët përmbajtësor do të jetë një akt i cili do të vijë në vijim dhe që do të respektohen normalisht edhe kritere të tjera të kodit apo pritshmëri të tjera siç është lista shumëmërore e cila ka dhe një afat. Në varësi të këtyre elementeve në vijim do të miratojmë aktin final i cili përbën dhe interesin më të madh të publikut apo të medias në këtë moment.



² Vendim nr. 198, datë 01.04.2021

Znj. I. Nano: Faleminderit zonja Vukaj, nëse ndonjë nga kolegët e tjerë dëshiron të shtojë diçka, apo të thotë diçka lidhur me projektaktin në parim, në vijim të asaj që tha zonja Vukaj? **Sigurisht që ky është akti i parë në kuadër të disa akteve deri në miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit. Sigurisht jemi në kushtet kur tashmë janë regjistruar subjektet zgjedhore dhe jemi në pritje të depozitimit pranë KQZ të listave të kandidatëve sikundër edhe zonja Vukaj e tha të cilët do të ndikojnë edhe në madhësinë e fletës së votimit. Është një proces i cili do të merret nga ana e Komisionit Rregullator në një të ardhme të afërt"**

Znj. I. Nano: "2. Komisioni Rregullator, mund të ndryshojë përmasat e fletës së votimit, në varësi të listave shumemërore për çdo zonë zgjedhore.


Çelimi diskutimin edhe për këtë pikë, në fakt unë pa rënë në përsëritje do të thoja që kjo pikë në projektvendim është parashkuar për t'i çelur rrugën undësisë së ndryshimit të atyre përm asave të fletës së votimit që ne sapo i votuam pra, në formatin A3, 297 mm me 420 mm. Në varësi të listave shumemërore për çdo zonë zgjedhore që do të dorëzohen do të rivlerësohet edhe një herë nëse do të jetë nevoja, pikërisht ky element".

Pikërisht nga *travaux préparatoires* e këtij akti të Komisionit Rregullator del qartë se në datën 26.02.2021 anëtarët e këtij organi ishin krejtësisht të bindur që ishte ky organi që do të miratonte fletën e votimit dhe kjo është arsyeja se përse përmasat e fletës në gjatësi dhe gjerësi janë përcaktuar si të ndryshueshme në varësi të përmbajtjes së fletës së votimit. Për shkak të faktit që ky organ, në datën 31.03.2021, vendosi të shpallë moskompetencën në lidhje me vendim m arrjen për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit dhe t'ia njohë këtë kompetencë Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, nuk mundet që t'i inponojë këtij të fundit përmasat e një flete votimi që ishin caktuar ende pa u depozituar listat shumemërore të kandidatëve të subjekteve zgjedhore për zgjedhjen për Kuvend të datës 25 Prill 2021.

Për më tepër, nëse i referohemi fjalisë së dytë të pikës 1 të nenit 98 të K.Zgjedhor që parashikon se "Fletët e votimit duhet të jenë prej letre, me ngjyrë, trashësi ose elemente konfigurimi të tilla që të mos lejojnë leximin e votës në pjesën e pasme të saj, si dhe të përmbajnë elemente sigurie, sipas përcaktimeve me akt normativ të KQZ-së", gjerësia dhe gjatësia e fletës së votimit nuk janë pjesë e elementeve që kanë të bëjnë me sigurinë e fletës së votimit, por me përmbajtjen e saj që rregullohen nga pikat 3 dhe 4 të këtij neni, kompetencë kjo për të cilën vetë Komisioni Rregullator ka shpallur moskompetencën.

Për rrjedhojë, në kushtet kur vetë Komisioni Rregullator, ka marrë dy vendime të ndryshme (datë 26.02.2021 dhe datë 31.03.2021) në lidhje me gjerësinë dhe gjatësinë e fletës së votimit si pjesë e





përbajtjes së fletës së votimit, do i referohemi vendimit nr. 00-2021-142, datë 01.02.2021 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë që ka arritur në përfundimin se:

"Në rastin objekt gjykimi, Kolegji konstaton se si ligji nr. 49/2012, ashtu edhe ligji nr. 98/2016 janë ligje të miratuara me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit (ligje të përforcuara) dhe me fuqi të njëjtë juridike. Gjithashtu, bazuar në analizën e parimit të specialitetit, referuar objektit të ligjeve, si dhe parashikimeve që përcaktojnë mënyrën e organizimit dhe funksionimit të pushtetit gjyqësor dhe gjykatave në veçanti, të dy ligjet bartin karakterin e tyre të posaçëm, në veçanti, lidhur me përbërjen e trupit gjykues. Në këto kushte, për sa kohë nuk mund të realizohet identifikimi i normës së posaçme, e cila ka përparësi dhe shmang normën e përgjithshme, në përputhje me kriterin e përgjithshëm juridik për zgjidhjen e kundërshtive (lex specialis derogat legi generali), raporti i specialitetit nuk mund të zbatohet (Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.19, datë 03.05.2007). Rrjedhimisht, Kolegji vlerëson si të ligjshëm dhe në përputhje me parashikimet kushtetuese rregullin e vendosur edhe nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese që lidhet me zbatimin e përparësisë së normës që ka hyrë në fuqi më vonë, në raport me normën e mëparshme" .


Është pikërisht kjo linjë arsyetimi edhe sa i përket dy vendimmarrjeve të Komisionit Rregullator që janë për të njëjtin objekt ku duhet të prevalojë vendimi i dytë i këtij organi që lidhet me zbatimin e përparësisë së normës që ka hyrë në fuqi më vonë, në raport me normën e mëparshme. Për rrjedhojë, miratimi i fletëve të votimit me përmasa të ndryshme nga ato të përcaktuara në vendimin nr. 6, datë 26.02.2021 të Komisionit Rregulltar është krejtësisht në përputhje me vetë vendimmarrjen e mëtejshme të Komisionit Rregullator të datës 31.03.2021, por dhe me nenin 98 të K.Zgjedhor.

4.Shumica, në vendimin e saj arsyeton me të drejtë se:

"Kodi Zgjedhor ka vendosur hapësirë diskreciale për KQZ-në në çështjen e formatimit të fletës së votimit. Kjo hapësirë diskreciale bëhet e nevojshme për shkak se numri i subjekteve pjesëmarrëse mund të ndryshojë shumë nga një zgjedhje në tjetrën. Por Kodi, bashkë me diskrecionin, i ka caktuar KQZ-së kufij të pakapërcyeshëm dhe të palëvizshëm. Këto kufij kanë të bëjnë me:

- *fleta e votimit duhet të jetë me ngjyrë dhe formë të njëjtë për të gjitha zonat zgjedhore (neni 97, pika 1);*
- *fletët e votimit duhet të jenë prej letre, me ngjyrë, trashësi ose elemente konfigurimi të tilla që të mos lejojnë leximin e votës në pjesën e pasme të saj, si dhe të përmbajnë elemente sigurie (neni 98, pika 1);*





- *emrat e subjekteve zgjedhore duhet të vendosen në fletën e votimit, sipas rendit të përcaktuar në mënyrë të rastësishme nga shorti. Përbri emrit të partisë duhet të vendoset sigla, shkronja nistore dhe emri i kryetarit të partisë (neni 98, pika 3);*
- *çdo subjekti që renditet në fletën e votimit duhet t'i korrespondojë hapësira përkatëse për shënimin e votës nga zgjedhësi (neni 98, pika 3).*
- *fleta e votimit për zgjedhjet për Kuvendin duhet të përmbajë hapësirën e posaçme për ushtrimin e votimit parapëlqyes për kandidatët e subjektit zgjedhor (neni 98, pika 4)".*

Fleta e votimit e miratuar me vendimin objekt i këtij shqyrtimi administrativ i plotësonte të gjitha kriteret e cituara më sipër nga anëtarët e shumicës, kriteret ligjore këto të parashikuara në nenet 97 dhe 98 të K.Zgjedhor. Përkundrazi, fleta e votimit e përzgjedhur nga shumica e anëtarëve të KAS nuk e plotëson të paktën njërin prej këtyre kriterëve, atë që *"fleta e votimit për zgjedhjet për Kuvendin duhet të përmbajë hapësirën e posaçme për ushtrimin e votimit parapëlqyes për kandidatët e subjektit zgjedhor (neni 98, pika 4)"*, pasi hapësira e supozuar për ushtrimin e votimit parapëlqyes për kandidatët e subjektit zgjedhor në këtë fletë, është e plotësuar paraprakisht me numra dhe e bën krejtësisht të paqartë dhe të pamundur shprehjen e vullnetit parapëlqyes nga zgjedhësit.


5.Më tej, shumica e anëtarëve të KAS ka vijuar me arsyetimin se:

"E drejta e KQZ-së për të kompozuar informacionin e fletës së votimit, sidomos përsa i përket mënyrës së votimit parapëlqyes duhet të respektojë kushtet:

- *informacioni i përcjellë nga fleta e votimit të mos jetë tejet i ngarkuar;*
- *konfigurimi i fletës të jetë i qartë e i kuptueshëm për zgjedhësin dhe*
- *zgjedhësi ta ketë të lehtë orientimin për votimin e subjektit zgjedhor dhe të kandidatit të parapëlqyer (neni 98, pika 4)".*

Të tre elementët plotësues të mësipërm, duke qenë shumë subjektivë është praktikisht e pamundur të përkufizohen në mënyrë shterruese nga pikëpamja sasiore në dispozitat e Kodit dhe në këtë kuptim ato janë elementë të cilët ligjvënësi ia ka lënë në dorë t'i përcaktojë organi administrativ kompetent për miratimin e fletës së votimit. Ky është një rast tipik i lejimit të ushtrimit të diskrecionit administrativ nga një organ publik. Diskrecioni i Komisionerit në interpretimin e elementëve plotësues në përgatitjen e fletës së votimit është dukshëm i pranuar duke konsideruar faktin se këto elemente të kërkuara nga kodi të cilat duhet t'i plotësojë fleta e votimit, në dukje mund të përmbushen nga më shumë se një variant apo projekt i fletës së votimit, por në fund është






gjykimi vlerësues i Komisionerit ai që vendos se cili nga projektet e fletës së votimit do të shndërrohet në fletë votimi të miratuar, çka edhe ka ndodhur në fakt.

Në këtë kontekst, në opinionin e anëtarëve në pakicë të KAS, ky i fundit duhet të kufizohej në shqyrtimin e faktit nëse Komisioneri në miratimin e fletës së votimit me vendimin objekt ankimi, ka vepruar në kundërshtim me kriteret bazë teknike të parashikuara në Kod dhe më pas nëse Komisioneri ka vepruar përtej diskrecionit administrativ që i është njohur atij nga K.Zgjedhor. Ose thënë ndryshe, KAS duhet të vlerësojë nëse Komisioneri ka shkelur ndonjë dispozitë urdhëruese të ligjit në marrjen e këtij vendimi dhe nëse ka ushtruar diskrecion të paligjshëm në miratimin e fletës së votimit me vendimin objekt gjykimi?!

Është pikërisht kjo pjesë e arsytimit që është thellësisht diskrecionale e organit që miraton fletën e votimit, pra në rastin konkret e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Arsyetimi i shumicës në lidhje me përmasat e mëdha të fletës së votimit "... e cila mundëson "lexin in" e votës nëpërmjet pozicionimit dhe lëvizjeve trupore që bën votuesi kur voton në fillim të një flete të madhe, apo kur voton në fund të saj, mund të jenë për zgjatjen në kohë të procesit të votimit, me qëllim që procesi të zvarritet dhe eventualisht një pjesë e votuesve të mbeten pa votuar, sikurse mund të jenë për vështirësimin e votimit, me qëllim që pavlefshmëria në votim të jetë e lartë" është krejtësisht subjektiv dhe nuk bazohet në asnjë dispozitë të K.Zgjedhor.

Në lidhje me argumentin e shumicës së anëtarëve të KAS se "Përfshirja e njëqind përqind të informacionit për kandidatët në fletën e votimit ... përbën shqetësim real për procesin e votimit, sepse përmasa e ekstremisht e madhe e fletës së votimit vështirëson përdorimin e saj përgjatë procesit të votimit, rrezikon tejmbushjen e kutive për shkak të madhësisë së fletës, kompromenton fshehtësinë e votimit, ngarkon administrimin përgjatë numërimit të votave, si dhe rrit potencialin manipulativ në numërim, veçanërisht për votat parapëlqyese të kandidatit. Përpos këtyre rreziqeve evidente, modeli i miratuar me këto përmasa rrit në mënyrë të pajustificueshme koston e prodhimit të tyre" edhe ai është i pabazuar. Më tej gjatë shqyrtimit administrativ në seancë publike, pas pyetjeve që ju bënë administratës së KQZ, rezultoi se edhe në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2013, përmasat e fletës së votimit kanë qenë të njëjta me ato të miratuara për këto zgjedhje nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe procesi është administruar në përputhje me K.Zgjedhor. Është e paqartë për ne anëtarët e pakicës se si rritet potenciali manipulativ në numërim, veçanërisht për votat parapëlqyese të kandidatit. P.sh. në qarkun e Tiranës, për vëzhguesit e Grupeve të Numërimit, është më e lehtë të dallojnë 36 numra të njëjtë për çdo subjekt zgjedhor apo emra dhe mbiemra të veçantë për çdo subjekt?! Në lidhje me koston e prodhimit, është një fakt që nuk u arrit të provohej në gjatë shqyrtimit administrativ, ndaj nuk mund të përdoret si argument, aq më tepër






që kostoja e fletëve të votimit nuk është një nga kushtet e përcaktuar në nenet 97 dhe 98 të K.Zgjedhor.

A ngum enti tjetër që përdor shumica e KAS në vendim marrjen e saj është se "Zgjidhja e dhënë për zvogëlimin e madhësisë së fontit, me qëllim që të sistemohen brenda fletës së votimit emrat e të gjithë kandidatëve që garojnë në zonën zgjedhore shkon dy herë në dëm të zgjedhësve, një herë për shkak të zvogëlimit të gërmës, të dytën për shkak të tejmbushjes me informacion". Pyetja që lind këtu është se mbiç'bazë bëhet ky krahasim sa i përket zvogëlimit të gërmave kur në fletën e miratuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka gërma në emrat e kandidatëve kurse në fletën e miratuar me vendim të KAS nuk ka asnjë gërme pjesë e listave të kandidatëve? Madhësia e fontit të numrave para emrave të kandidatëve është e njëjtë me madhësinë e numrave të kandidatëve në modelin e fletës së votimit të miratuar me vendim nga KAS, ndaj ky argument nuk qëndron. Pyetje tjetër është se cili kriter përdoret për të arritur në përfundim in e "tejmushjes me informacion"?! Përme anëtarëte pakicës në KAS, "tejmushje me informacion" konsiderohet përdorim i numrave natyrorë në mënyrë të përsëritur në të njëjtën fletë votimi, tejmbushje kjo që sjell dhe paqartësi për zgjedhësin. Përsë është më pak "tejmushje me informacion" përdorim i numrave natyrorë në mënyrë të përsëritur dhe jo përdorimi i emrave të përveçëm ta kandidatëve të subjekteve zgjedhore?! Janë të gjitha këto pyetje që tregojnë se argumentet e shumicës janë subjektive dhe nuk kanë asnjë element ligjor për të ndryshuar vendimmarrjen e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Në përfundim të arsyetimit të tyre në lidhje me përmbajtjen e fletës së votimit, shumica e anëtarëve të KAS, arsyeton se "Kodi zgjedhor kërkon në mënyrë taksative që fletët e votimit të kenë të njëjtën ngjyrë dhe të njëjtën formë në të gjitha zonat zgjedhore. Por Kodi nuk kërkon që fletët e votimit të kenë të njëjtën përmasë dhe të njëjtën përmbajtje në të gjitha zonat. Komisioneri mund të kishte marrë në konsideratë këtë hapësirë ligjore dhe t'i kishte rekomanduar Rregullatorit që të adoptonte zgjidhje alternative nga një zonë në tjetrën, për të pajtuar kërkesat e subjekteve me nevojën për të mbajtur fletën e votimit të thjeshtë, të qartë, të kuptueshme dhe të lehtë në orientim. Një gjë e tillë mund të realizohej p.sh. me fletën e votimit në Kukës, ku garojnë 12 subjekte dhe 36 kandidatë, e cila krijon mundësi krejtësisht të tjera krahasuar me fletën e votimit në Tiranë, ku garojnë 13 subjekte dhe 433 kandidatë". Nëse Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk e mori në konsideratë këtë hapësirë ligjore të supozuar nga shumica e anëtarëve të KAS, atëherë përse nuk e mori vetë KAS në konsideratë këtë hapësirë meqenëse kishte dy modele fletësh votimi objekt të këtij shqyrtimi administrativ, atë të miratuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe atë të propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, njëra me emra kandidatësh dhe tjetra me numra?! Meqenëse KAS mori përsipër që të kufizonte ushtrimin e ligjshëm të





diskrecionit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, përtej atyre që përcakton K.Zgjedhor për fletën e votimit, mundet që ta shfrytëzonte dhe këtë hapësirë ku ta trajtonte veçmas qarkun e Tiranës nga qarqet e tjera.

6. Është pikërisht arsyetimi sipërcituar që tregon se shumica e anëtarëve të KAS, e kanë ndryshuar vendimmarrjen objekt shqyrtimi administrativ të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, duke e cënuar këtë të fundit në parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit. Më konkretisht pika 3 e nenit 3 të K.Pr.Adm inistrative përkufizon "diskrecionin e organit publik" si "e drejta e këtij të fundit për të ushtruar autoritet publik për të përmbushur një qëllim të ligjshëm, në rastet kur ligji parashikon pjesërisht modalitetet për të arritur këtë, duke i dhënë hapësirë vlerësimi zgjedhjeve të organit publik". Ndërkohë neni 11 i K.Pr.Adm inistrative, e sanksionon në mënyrë të detajuar parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit duke parashikuar se:

"Diskrecioni ushtrohet ligjërisht kur ai është në përputhje me kushtet e mëposhtme:


- a) është i parashikuar me ligj;*
- b) nuk tejkalon kufijtë e ligjit;*
- c) zgjedhja e organit publik është bërë vetëm për të arritur objektivin për të cilin është lejuar diskrecioni dhe është në përputhje me parimet e përgjithshme të këtij Kodi; dhe;*
- ç) zgjedhja nuk përbën një shmangie të pajustificuar nga vendimet e mëparshme të marra nga i njëjti organ në raste të njëjta apo të ngjashme".*

Pra, ligji krijon një hapësirë për alternativë vendimmarrëse për organet publike në raste përjashtimore. Organi publik duhet të respektojë dispozitat e përcaktuara në nenin 11 të K.Pr.Administrative nëse është i autorizuar të zgjedhë midis dy ose më shumë alternativave të ligjshme gjatë zbatimit të ligjit në një rast të veçantë. Në lidhje me kushtet që duhet të plotësohen për të ushtruar diskrecionin nga ana e organit publik, argumentojmë se:

a. Diskrecion i parashikuar me ligj (shkronja "a")

Dispozita e parashikuar në shkronjën "a" nuk ka të bëjë me ushtrimin e diskrecionit si të tillë, por me parakushtin e dhënies së pushtetit diskrecionar. Norma e zbatueshme duhet të analizohet nëse ajo ka dhënë apo jo diskrecion. Në shumicën e rasteve formulimi i ligjit tregon qartazi vendimin që duhet të merret. Në rast të kundërt, nëse pasoja ligjore e një norme specifike nuk zbatohet në mënyrë strikte por varet nga një "vlerësim" i organit publik që ka mundësi të zgjedhë ndërmjet zgjedhjeve të ndryshme, atëherë mund të thuhet se norma parashikon diskrecion. Pikat 3 dhe 4 të nenit 98 në raport më pikënl të po këtij neni të K.Zgjedhor janë rast tipik i diskrecionit të parashikuar në ligj në lidhje me formatimin konkret dhe fletës së votimit sa i përket reflektimit të





përmbajtjes në fletën e votimit. Mjafton që të plotësohen kushtet e kërkuara në këtë nen, në mënyrë që të jemi në përputhje me këtë dispozitë.

b. Nuk tejkalon kufijtë e ligjit (shkronja "b")

Dispozita e shkronjës "b" kërkon që organi publik të sigurohet që do të marrë vendimin e tij diskrecionar brenda kufijve të pasojave juridike të ligjit. Neni 98 dhe interpretimi më sipër që kemi bërë në lidhje me përmasat e fletës së votimit, tregon qartazi se jemi në kushtet kur vendimmarrja e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nuk i tejkalon kufijtë e ligjit. Madje vetë shumica në argumentin e saj të sipërcituar asyeton ndër të tjera se "... Kodi nuk kërkon që fletët e votimit të kenë të njëjtën përmasë dhe të njëjtën përmbajtje në të gjitha zonat", pra jemi brenda kufijve të ligjit.

c. Nuk tejkalon objektivin e ligjit (shkronja "c")


Dispozita e parashikuarnë shkronjën "c" përbën parakushtin për ushtrimin e diskrecionit. Organi publik duhet të marrë parasysh objektivat ligjore të ligjit diskrecionar dhe duhet të orientojë vendimin drejt arritjes së këtyre objektivave. Duke vepruar në këtë mënyrë, organi publik duhet të vlerësojë rëndësinë e objektivave në rastin e veçantë dhe të marrë parasysh se deri në çfarë mase mund të arrihen objektivat nëpërmjet zgjedhjeve të dhëna. Edhe sa i përket këtij kushti, fleta e votimit e miratuar me vendimin objekt i këtij shqyrtimi administrativ, nuk e tejkalon objektivin e ligjit, përkundrazi fleta e miratuar me vendimin e KAS e tejkalon objektivin e ligjit.

d. Asnjë shmangie e pajustificuar në raport me rastet e njëjta ose të ngjashme (shkronja "ç")

Ky është një kusht i domosdoshëm për shkak të parimit të barazisë siç parashikohet në nenin 18 të Kushtetutës dhe vetë nenin 17 të K.Pr.Administrative, ku organi publik nuk duhet të përdorë fuqinë e tij diskrecionare për të trajtuar çështje të njëjta në mënyra të ndryshme pa arsye thelbësore. Sa i përket votës preferenciale të kandidatëve, nuk mund ta krahasojmë me raste të ngjashme, por sa i përket përmasës së fletës së votimit, është një përmasë që është përdorur dhe më parë, në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2013. Në lidhje me barazinë e subjekteve zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021, nuk ka asnjë shmangie për atë kohë sa ato trajtohen në mënyrë të barabartë në çdo fletë votimi.

Pas analizës së detajuar që i bëmë vendimmarrjes konkrete të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në raport me nenin 11 të K.Pr.Administrative që parashikon parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit, arrijmë në përfundimin që fleta e votimit e miratuar me këtë vendim është tërësisht në përputhje me këtë parim. Ajo se çka duhet të analizonte KAS në rastin objekt shqyrtimi administrativ, duhet të ishte vetëm kontrolli nëse janë përmbushur apo jo kushtet e nenit 11 të K.Pr.Administrative në mënyrë kumulative në përputhje me






nenet 97 dhe 98 të K.Zgjedhor. Shumica e anëtarëve të KAS, në vendimmarrjen e tyre kanë dështuar ta bëjnë këtë analizë, por kanë gjykuar *a priori* një vlerësim të organit publik që është rast tipik i ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit.

7. Në lidhje me ndryshimin e modelit të fletës së votimit nga shumica e anëtarëve të KAS dhe zëvendësimin e emrave dhe mbiemrave të kandidatëve me numra në fletën e votimit, jemi në kushtet e paligjshmërisë pasi nëse do i referohemi modelit të Kosovës që përdor numrat në vend të emrave të kandidatëve, do të vëmë re se në ligjin nr. 03/L-073 "Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës" ka parashikim në lidhje me mënyrën se si zgjedhësit lidhin numrin e kandidatit në fletën e votimit me emrin dhe mbiemrin e kandidatit në listat shumëmbërëse të subjekteve zgjedhore. Më konkretisht, pika 3 e nenit 87 të këtij ligji parashikon se "Emrat e të gjithë kandidatëve në materialin e shtypur të ekspozuara në vendvotime ose Qendra të Votimeve shfaqen drejtpërdrejtë nën emrin e partisë politike, koalicionit ose nismës qytetare që ka dorëzuar listën e kandidatëve" dhe ky detyrim parashikohet në nenin me titull "Përshkrimi i Fletëvotimit dhe materialit në lidhje me Fletëvotimin". Më tej, pika 2 e nenit 107 të po këtij ligji parashikon se "Në secilin vendvotim, në ditën e zgjedhjeve, materiali i shtypur, i dizajnuar dhe i përgatitur në emër të KQZ-së, me emra të numëruar të subjekteve politike dhe emrave të kandidatëve, e po ashtu edhe të procedurave të votimit, nxirret, ekspozohet ose publikohet nga Sekretariati i KQZ-së në dobi të votuesve. Emrat e kandidatëve në materiale të tilla të shtypura ose të ekspozuara renditen në të njëjtën mënyrë siç paraqiten në listën e regjistrimit të kandidatëve, të certifikuar nga KQZ-ja në lidhje me subjektet politike të cilat i kanë paraqitur". **Duket qartë që një K.Zgjedhor që synon identifikimin e kandidatëve me numra dhe jo me emra, parashikon dhe mënyrën e informimit të zgjedhësve për këtë mënyrë identifikimi, duke garantuar që dhe zgjedhësi më i informuar në lidhje me procesin dhe kandidatët, të ketë mundësinë që të informohet që Qendrën e Votimit në lidhje me mundësitë që ka për përzgjedhjen.** Kodi ynë Zgjedhor nuk ka asnjë parashikim në lidhje me informimin e zgjedhësve në qendrën e votimit për të identifikuar se cili numër i përket një kandidatit konkret. Ndaj duket qartë që nuk ka qenë në synimin e ligjvënësit një fletë votimi e tillë që çënon pikën 1 të nenit 45 të Kushtetutës që parashikon se "Çdo shtetas që ka mbushur tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet". Nëse e drejta për të zgjedhur është e tillë që nuk mund të ushtrohet thjesht me informacionin që merr vetëm duke i'u drejtuar qendrës së votimit ditën e zgjedhjeve, atëherë është e kufizuar tej kriterit të moshës dhe asaj të zotësisë për të vepruar. Ligjvënësi në Republikën e Kosovës, përveçse e ka detajuar në ligjin zgjedhor këtë çështje, ka autorizuar KQZ për nxjerrjen e rregullave për fletët e votimit dhe broshurat orientuese për zgjedhësit të cilat i cituam më sipër. Përkundrazi për këtë arsye KQZ ka nxjerrë Rregullën Nr. 01/2020 "Për fletëvotimin et dhe broshurat" ku ka përcaktuar në mënyrë të detajuar specifikimet e fletëve të votimit, por edhe të broshurave ku





pasqyrohen emrat e mbiemrat e kandidatëve. Në rastin tonë, zbatimi i diskrecionit nga KAS për të zëvendësuar emrat e mbiemrat e kandidatëve me numra natyrorë të përsëritur, në një vakum të plotë ligjor në lidhje me konkretizimin e këtyre numrave me kandidatët në lista shumëemronë cënon të drejtën kushtetuese për të zgjedhur dhe për t'u përfaqësuar në Kuvend.


8. Nëse i referohemi neneve 67 pika 4³, 106 pika 1⁴ dhe 117 pika 2⁵ të K.Zgjedhor del qartë fryma e kodit pasi kudo përmendet termi i "kandidat", çka do të thotë se si kandidat, m e emër dhe m e mbiemër, do të duhet të identifikohet edhe në fletën e votimit, aq më tepër kur vetë kodi nuk përcakton ndonjë detyrim shtesë, si në rastin e Republikës së Kosovës, për informacion të detajuar dhe të miratuar njësoj si për fletën e votimit për zgjedhësin në qendrën e votimit. **Përdorimi i numrave në mënyrë të parregulluar me akt normativ në fletën e votimit sjell paqartësi dhe konfuzion në kuptim të detyrimeve të vendosura në nenet 97 dhe 98 të K.Zgjedhor për aq kohë sa i njëjti numër mund të identifikojë dhe një subjekt zgjedhor e po ashtu dhe një kandidat, apo që kandidatë të ndryshëm në qarqe të ndryshme kanë të njëjtët numër në fletën e votimit, çka realisht e bën krejtësisht të pamundur fushatën zgjedhore me numra në media dhe për më tepër në kohë pandemie kur dhe fushata zgjedhore po zhvillohet në kushte të tjera nga ato normale.** A mund të konsiderohet se po ushtrohet sipas Kushtetutës e drejta për t'u zgjedhur kur m e të njëjtin numër janë disa kandidatë që bëjnë fushatë zgjedhore në media në qarqe të ndryshme dhe kur njëkohësisht e drejta për t'u grupulluar në aktivitete politike është e kufizuar për shkak të situatës së pandemisë?! Rasti i Republikës së Kosovës është i ndryshëm dhe në këtë pikë, pikërisht që mos të sjellë paqartësi dhe konfuzion të zgjedhësit. Numri i subjekteve zgjedhore fillon nga 111 e në vijim, ndërkohë që numri i kandidatëve në fletën e votimit sipas sistemit zgjedhor proporcional kombëtar (me 1 zonë dhe jo 12 zona të ndryshme si në rastin tonë) fillon nga 1 deri në 110 në mënyrë që gjatë fushatës çdo kandidat të ketë një numër të ndryshëm nga kandidati tjetër brenda të njëjtit subjekt zgjedhor, por dhe një numër të ndryshëm më subjektin zgjedhor. Sistemi ynë zgjedhor nuk ka asnjë parashikim të tillë ndaj p.sh. me numër 3 mund të identifikosh një subjekt zgjedhor, por dhe dymbëdhjetë kandidatë të po të njëjtit subjekt zgjedhor në zona zgjedhore të ndryshme, por që mund të bëjnë fushatë në të njëjtat media.



³ "4. Emrat në listën shumëemërore të subjektit zgjedhor paraqiten të renditura sipas rendit shifror, duke filluar nga numri një. Numri i kandidatëve në listën shumëemërore nuk mund të jetë më i vogël se numri i mandateve që do të zgjidhen në zonën zgjedhore përkatëse, shtuar dy. Në çdo rast, numri i kandidatëve në listën shumëemërore duhet të jetë i plotpjesëtueshëm me numrin tre. Për koalicionet përbri emrit të kandidatit shënohet cilës parti i përket kandidati".

⁴ "1. Pasi merr fletën e votimit, zgjedhësi hyn i vetëm në dhomën e fshehtë dhe në fletën e votimit shënon në vendin e përcaktuar nga fleta e votimit për subjektin zgjedhor dhe/ose kandidatin e parapëlqyer të subjektit zgjedhor shenjë "x" ose "+" ose një shenjë tjetër që tregon qartë zgjedhjen e bërë prej tij".

⁵ "2. Vota të vlefshme janë vetëm fletët e votimit, në të cilat është votuar qartësisht vetëm për njërin nga subjektet zgjedhore dhe/ose vetëm për njërin nga kandidatët e tij. Kur është votuar për më shumë se një kandidat të të njëjtit subjekt zgjedhor, vota i llogaritet vetëm subjektit zgjedhor".



9. Si përfundim, në lidhje me pranimin e kërkesës ankimore nr. 8, datë 01.04.2021 të subjektit Zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, shumica e anëtarëve të KAS, përveçse kanë cënuar parimin e diskrecionit të ushtruar ligjërisht nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, por me vendimmarrjen e tyre kanë cënuar dhe K.Zgjedhor me miratimin e një flete votimi që kandidatët në listat shumemërore të subjekteve zgjedhore i kanë shndërruar nga emra të përveçëm në numra natyrorë të përsëritur, çka për ne bie ndesh me nenin 98 të K.Zgjedhor.

Të gjitha argumentet e ngritura nga anëtarët e shumicës, në opinionin tonë janë thjesht pikëpamje personale vlerësuese dhe krejtësisht subjektive të tyre. Vendimi i shumicës ka analizuar vetëm elementët subjektivë apo diskrecialë që Komisioneri duhet të merrte në konsideratë gjatë përgatitjes së fletës së votimit, çka është e pamjaftueshme për të konkluduar në mënyrë të drejtë në paligjshmërinë e vendimit të miratimit të fletës së votimit. Sikurse rezultoi edhe nga seanca dëgjimore në KAS, nuk ekziston asnjë provë në formën e ekspertizës apo të eksperimentit konkret i cili të vërtetojë që opinionet apo argumentet e anëtarëve të shumicës në KAS lidhur me kriteret plotësuese janë më të sakta apo më të pëlqyera nga zgjedhësit se argumentet e Komisionerit të materializuara në fletën e votimit të miratuar me vendimin objekt ankimi. Në këtë kushte, në opinionin tonë, rrëzimi i vendimit nr. 198, datë 1.4.2021 të Komisionerit është bërë thjesht dhe vetëm bazuar në vlerësimin e subjektive apo "shije personale".

Pra de facto, KAS duke shfuqizuar një vendim të Komisionerit vetëm bazuar në pikëpamjen subjektive të anëtarëve të shumicës dhe duke mos analizuar dhe evidentuar nëse ka shkelje të ligjit nga ana e Komisionerit, i ka dhënë vetes kompetenca të përgatisë tashmë ai vetë fletën e votimit, kompetenca të cilat Kodi zgjedhor nuk ia njeh.


Për sa më sipër, ankimi i paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste duhet të rrëzohej.

Pikërisht për të njëjtat arsye të cituara më sipër, në anëtarët në pakicë jemi të mendimit se duhet të rrëzohej edhe ankimi i subjektit zgjedhor Koalicioni PD - AN në lidhje me orientimin e fletës së votimit të miratuar me vendimin nr. 198, datë 1.4.2021 të Komisionerit.

10. Në anëtarët në pakicë, të njëjtin qëndrim mbajmë edhe në lidhje me kërkesën ankimore nr. 9, datë 01.04.2021 të subjektit zgjedhor Partia Bindja Demokratike. Ajo duhet të ishte rrëzuar pasi ky subjekt nuk arriti të provojë se logo (emblema apo stema) që ka depozituar në KQZ me shkresën 3010/1, datë 01.04.2021, ora 15:50 është e njëjtë me atë që ka depozituar në regjistrin e partive politike, parashikuar në nenin 9⁶ të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 "Përpartitë politike" indryshuar.

⁶ "Regjistrimi i partive politike bëhet në gjykatën e shkallës së parë të rrethit të Tiranës, e cila mban regjistrin e partive politike. Në regjistrin e partive politike shënohet numri rendor i regjistrimit, numri i aktit, numri i vendimit






Madje dhe vetë neni 12 i po këtij ligji, në fjalinë e tij të dytë, parashikon se *"Inicialet dhe emblemat e partive politike nuk duhet të përputhen"*.

Interpretimi që shumica e anëtarëve të KAS i bën nenit 66 të K.Zgjedhor është interpretim literal që me qëllim përjashton interpretimin teleologjik (qëllimor) të kësaj dispozite. Është e vërtetë që subjekti zgjedhor Koalicioni Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim është regjistruar në kohë më vonë se subjekti zgjedhor Partia Bindja Demokratike, por është po ashtu e vërtetë që emblema që përdor ky koalicion është e njëjtë me atë të Partisë Demokratike që e ka emblema të saj që nga zgjedhjet e para pluraliste në vend. Interpretimi i dispozitës sipas arsytimit të shumicës së anëtarëve të KAS do të kishte kuptim nëse subjekti zgjedhor koalicioni PD – AN do të kishte krijuar një emblema të re enkas për koalicionin në këto zgjedhje, emblema kjo që do të ngjasonte me atë të subjektit zgjedhor Partia Bindja Demokratike. Gjithashtu nuk mund të bëhet krahasim ndërmjet datës së themelimit të një partie politike (Bindja Demokratike në këtë rast) me një koalicion partish. Një krahasim i tillë do të kishte kuptim vetëm nëse do të kishim përballë dy parti politike ose dy koalicione partish. Në këtë kontekst, në rastin konkret për efekt të përcaktimit të të drejtës së përdorimit të emblemes, duhet të krahasohen dy partitë politike Bindja Demokratike dhe Partia Demokratike e cila është edhe partia udhëheqëse e koalicionit (i cili për më tepër ka si emblema pikërisht emblema të kësaj partie). Në këtë kontekst, referuar datës së themelimit ligjor, i takonte Partisë Demokratike të mbante emblema të saj në fletën e votimit ndërsa emblema e paraqitur nga Partia Bindja Demokratike duhet të ndryshohej pikërisht për shkak se ngjashmëria e saj me emblema të Partisë Demokratike mund të shkaktojë konfuzion ose lajthitje të votuesve. Për aq kohë sa nuk jemi në këto kushte, atëherë neni 66 i K.Zgjedhor duhet të interpretohet sipas linjës së arsytimit që ka ndjekur dhe Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Komisioneri gjatë procesit të miratimit të fletës së votimit me të drejtë, duke konstatuar ngjashmërinë e dy emblemave, i ka dhënë mundësinë Partisë Bindja Demokratike të ndryshojë emblema për të evituar ngjashmëritë konfonduese. Në kushtet kur ngjashmëria e emblemave nuk është shmangur as pas ristilizimit të emblemes së Partisë Bindja Demokratike, me të drejtë Komisioneri ka vendosur që në fletën e votimit kjo parti të ketë një emblema të cilën ruan inicialet e partisë dhe njëkohësisht eviton ngjashmërinë konfonduese me emblema të Partisë Demokratike. Për sa më sipër, ankimi i paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Bindja Demokratike duhet të rrëzohej.



gjqësor, data e shpalljes, dispozitivi i vendimit, emri i plotë i partisë, inicialet e partisë, stema e partisë, përshkrimi i konfiguracionit të vulës, emri i kryetarit, numri i anëtarëve themelues shënime për ndryshimin e emrit, konfiguracione të vulës ose të kryetarit të partisë, fshirjes apo mbarimit të veprimtarisë së subjektit, data e bërjes së shënimit, emri, si dhe nënshkrimi i nëpunësit kompetent".



11. Në lidhje me kërkesën ankimore nr. 10, datë 02.04.2021 të subjektit zgjedhor Koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim, në anëtarët e pakicës, kemi të njëjtin qëndrim me shumicën për rrëzimin e saj si në lidhje me fletën e votimit, po ashtu edhe në lidhje me logon e subjektit zgjedhor Partia Bindja Demokratike, por me arsyetim tjetër.

Sa i përket fletës së votimit, kërkin ipërtindryshuar orientimin nga *landscape* (horizontalisht) në *portrait* (vertikalisht), është një kërkim që nuk ka të bëjë me kriteret ligjore të parashikuara në K.Zgjedhor si dhe është pjesë e parimit të ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Për aq kohë sa Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk e ka cënuar këtë parim, atëherë ai është në kushtet e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit ndaj nuk është KAS organi që mund të gjykojë këtë diskrecion për aq kohë sa ai është ushtruar në përputhje me K.Zgjedhor.

I njëjti argument vlen edhe në lidhje me kërkimin tjetër që ka të bëjë me logon (emblemën) e subjektit zgjedhor Partia Bindja Demokratike. Është Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve që nëpërmjet zbatimit të nenit 66 të K.Zgjedhor, ka vendosur sipas parimit të ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit emblemën që do të ketë ky subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend të 25 Prillit 2021. Për ne anëtarët në pakicë është gjithashtu i papranueshëm pretendimi dhe interpretimi i nenit 66 të K.Zgjedhor nga subjekti zgjedhor Koalicioni PD - AN sipas të cilit Partia Bindja Demokratike nuk duhet të ketë asnjë emblemë në fletën e votimit. Duke gjykuar se një veprim i tillë do të cënonte gjithashtu parimin e barazisë së armëve në një proces konkurrues sikurse janë zgjedhjet, ne anëtarët në pakicë janë të mendimit se ankimi i Koalicionit PD - AN edhe për këtë pikë duhet të rrëzohet. Ajo çka mund të kundërshtonte koalicioni PD – AN, do mund të merrej për bazë nëse Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve do të keqinterpretonte nenin 66 të K.Zgjedhor, por për aq kohë sa ai e ka interpretuar në mënyrën e duhur, atëherë kërkesa ankimore e subjektit koalicioni PD – AN duhet të rrëzohet sipas këtij arsytimi.

12. Për sa më sipër, ne anëtarët në pakicë vlerësojmë se të tre kërkesat ankimore të paraqitura nga subjektet zgjedhore Partia Socialiste e Shqipërisë, Partia Bindja Demokratike dhe Koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim, janë të pabazuara dhe ato duhet të ishin rrëzuar nga Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve. Ne theksojmë se pavarësisht kompetencës së KAS për të shqyrtuar kërkesat ankimore ndaj akteve të Komisionerit Shtetëror, kjo kompetencë nuk duhet të kuptohet si kufizim i parimit të ushtrimit të diskrecionit ndaj Komisionerit Shtetëror i Zgjedhjeve.


Elvis ÇEFA

Ledio BRAHO



Data: 3 Prill 2021
Nr. 19, ora 11

Përshqyrja në kërkesave ankimore nr.08, nr.09 dhe nr.10, ndaj vendimit të KSHZ nr.198,
datë 01.04.2021





Nr. 143 Prot.

Tiranë, më 15.03.2023



Drejtuar: Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
Rruga "Ibrahim Rugova", Nr. 4 Tiranë.

Lënda: Kërkesë për regjistrimin në KQZ të koalicionit zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14.05.2023.

Mbështetur në nenin 65 e vijues të Ligjit Nr. 10019 datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Partia "PARTIA E LIRISË", si parti udhëheqëse e koalicionit, i kërkon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve regjistrimin e koalicionit zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14.05.2023

Emri i koalicionit është : **"BASHKË FITOJMË"**

Shkronjat nistore të Koalicionit do të jenë: **"BF"**

Sigla e Koalicionit është:



Partitë përbërëse të koalicionit janë:

- Partia e Lirisë;
- Partia Demokratike e Shqipërisë;
- Partia Demokristiane;
- Partia e Bashkimit për të Drejtat e Njeriut;

Në përputhje me kërkesat e dispozitës së sipërpërmendur të Kodit Zgjedhor, së bashku me kërkesën tonë për regjistrim po ju paraqesim edhe marrëveshjen përkatëse e cila detajon të gjitha elementet e kërkuara nga neni 65 i Kodit Zgjedhor dhe nga Udhëzimin nr. 1 datë 23.12.2020 i KQZ-së.

Përfaqësuesi

Nënkryetari

Endrit Braimllari



MARRËVESHJE

PËR

KRIJIMIN E KOALICIONIT “BASHKË FITOJMË”

Sot më datë 15.03.2023, ne, partitë politike të mëposhtme:

Po bashkohemi, si parti dhe si qytetarë, jo vetëm për të shmangur rrezikun e eliminimit të pluralizmit dhe pengmarrjen e opozitës, por edhe me qëllimin e lartë për t'i sjellë ndryshimin Shqipërisë, qytetarëve të saj dhe bashkatdhetarëve jashtë vendit.

Ne po bashkohemi si garant i fitores së opozitës dhe forcave euroatlantike në zgjedhjet e ardhshme, për t'i dalë zot Shqipërisë, dhe për të garantuar ndryshimin përmes zgjedhjeve dhe dhënien fund të status quo-së politike dhe abuzimit të pushtetit.

Bashkimi si garant i ndryshimit dhe instrument për forcimin e zërit qytetar opozitar, na bën bashkë dhe më të fortë.

Ne theksojmë nëpërmjet këtij bashkimi të njëjtat vlera e parime në veprimtarinë e përgjithshme politike, si dhe në vizionin për qeverisjen e vendit. Dëshirojmë të koordinojmë angazhimet dhe kontributin për fitoren e përbashkët politike dhe prandaj

VENDOSËM :

1. Të formojmë një Koalicion opozitar dhe për të konkuruar së bashku në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.
2. Emri i koalicionit është: “**Bashkë Fitojmë**”
3. Shkronjat nistore të Koalicionit do të jenë: “**BF**”

Sigla e Koalicionit është:



Drejtuese politike e koalicionit është **Partia Demokratike e Shqipërisë** e përfaqësuar nga organet drejtuese të saj.

Partia udhëheqëse e koalicionit, sipas parashikimeve të nenit 65 e vijues të Kodit Zgjedhor është **Partia e Lirisë**.

4. Të autorizojmë z. Ilir Metaj, Kryetar i Partisë së Lirisë, ose të autorizuarin prej tij, që të paraqesë pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) dhe ose KZAZ, kandidatët për kryetar bashkie në çdo njësi, listat e kandidatëve për këshillat bashkiake si dhe çdo dokumentacion tjetër të nevojshëm për regjistrimin e koalicionit dhe kandidatëve dhe listave të këshilltarëve, për çdo zonë zgjedhore, deri në përfundim të procesit zgjedhor.

5. Të autorizojmë z. Endrit Braimllari që:

- a. Të paraqesë kërkesë për regjistrimin e Koalicionit, së bashku me këtë marrëveshje, pranë KQZ-së.
- b. Të përfaqësojë Koalicionin gjatë procedurës së shortit, në KQZ, për renditjen e subjekteve zgjedhore në fletën e votimit.
- c. Të caktojë vëzhguesit e Koalicionit në KZAZ-të, KQV-të dhe VNV-të, në të gjithë vendin.
- d. Të përfaqësojë Koalicionin dhe/ ose të autorizojë përfaqësues të tjerë, për t'a përfaqësuar atë pranë KQZ, Kolegjit Zgjedhor ose instancave të tjera administrative dhe gjyqësore ku do të konsiderohet e nevojshme. Ai ka të drejtë të nënshkruaj për sa më sipër.

6. Termat konkrete të bashkëpunimit brenda koalicionit do të përcaktohen nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe të partive politike në përbërje të tij.

7. Në listat shumëemërore për këshilltarë të Koalicionit zgjedhor do të përfshihen, për çdo parti të koalicionit, numri i kandidatëve dhe renditja e tyre, bazuar në marrëveshjet midis palëve. Kandidatët në listat shumëemërore të Koalicionit, pavarësisht se cilës parti i përkasin, do të konsiderohen dhe vlerësohen si kandidatë vetëm të Koalicionit, duke shmangur trajtimin e tyre sipas përkatësive partiake.

8. Kjo marrëveshje hyn në fuqi menjëherë ditën e nënshkrimit të saj.



PËR

PARTINË E LIRISË

KRYETARI

Ilir Metaj



**PARTITË E KOALICIONIT, FIRMËTARE TË KËSAJ MARRËVESHJE,
JANË:**




**Partia
Demokratike**

PËR

PARTINË DEMOKRATIKE TË SHQIPËRISË

KRYETARI

Sali Berisha



PËR

PARTINË BASHKIMI PËR TË DREJTAT E NJERIUT

KRYETARI

Vangjel Dule





PËR

PARTINË DEMOKRISTIANE TË SHQIPËRISË

KRYETARI

Nard Ndoka



Z. P. Hoxha
[Signature]

KUVENDI
NR. 609 DATE 16.02.23



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI
LEGJISLATURA X

Zy. Haris R. L.
Zy. Haris F. L.
p. i. t. g. b. i.

VETËDEKLARIM

9.1
16.02.23

Bazuar në nenin 68¹, pika 3, të ligjit nr. 10019 , datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar) deklaroj, se aktualisht jam deputet i Kuvendit të Shqipërisë dhe:

Përfaqësoj partinë politike “Partia e Lirisë”

Jam deputet i pavarur.

DEPUTETI

PETRIT KOZMA VASILI

[Signature of Petrit Kozma Vasili]

TIRANE DATË 16.02.2023

¹ Neni 68 Listat mbështetëse të partive politike dhe koalicioneve (Ndryshuar me ligjin nr.74/2012, datë 19.7.2012, zëvendësuar togfjalësh në pikën 3 me ligjin nr. 118/2020, datë 5.10.2020) 1. Listat e kandidatëve për Kuvendin, të paraqitura nga partitë politike, të cilat nuk zotërojnë asnjë mandat në Kuvend, duhet të mbështeten nga jo më pak se 5,000 zgjedhës në shkallë kombëtare. Në rastin e koalicionit zgjedhor listat në tërësi duhet të kenë marrë 35 mbështetjen e jo më pak se 7,000 zgjedhësve në shkallë kombëtare. Bën përjashtim nga ky rregull koalicioni, ku partitë pjesëtare zotërojnë bashkërisht në Kuvend një numër mandatesh jo më të vogël se numri i partive pjesëtare të koalicionit. 2. Kandidatët për organet e njësisë së qeverisjes vendore, të paraqitur nga partitë politike, të cilat nuk zotërojnë asnjë mandat në Kuvend ose në organet e njësisë përkatëse të qeverisjes vendore, duhet të mbështeten nga jo më pak se 1 për qind e zgjedhësve të asaj njësie, por, në çdo rast, jo më shumë se 3,000 dhe jo më pak se 50 zgjedhës. Bën përjashtim nga ky rregull koalicioni, ku partitë pjesëtare zotërojnë bashkërisht në Kuvend një numër mandatesh jo më të vogël se numri i partive pjesëtare të koalicionit, ose kur zotërojnë bashkërisht në këshillin përkatës një numër mandatesh jo më të vogël se numri i partive pjesëtare të koalicionit. 3. Për qëllim të këtij neni, partia politike ose koalicioni paraqet një vërtetim me shkrim, të nënshkruar nga institucioni i Kuvendit apo njësia e qeverisjes vendore, ku vërtetohet zotërimi i mandatit të paktën 6 muaj para përfundimit të mandatit të Kuvendit ose të organit të njësisë së qeverisjes vendore, në bazë të vetëdeklarimit të zotëruesve të mandateve për përkatësinë në partinë politike. në institucionin përkatës.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 609/ Prot.
11

Datë 20.02. 2023

V È R T E T I M

Bazuar në nenin 68, pika 2 dhe 3, të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, vërtetohet se në bazë të vetëdeklarimit të paraqitur në institucionin e Kuvendit, deputeti Petrit Kozma Vasili zotërues i mandatit në Kuvend, ka deklaruar përkatësinë në partinë politike “Partia e Lirisë”.

Lëshohet ky vërtetim sipas kërkesës së deputetit të interesuar.

Bashkëlidhur një kopje e vetëdeklarimit të deputetit.

Gene GJONÇAJ
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM



KUVENDI

777 01.03.23



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

LEGJISLATURA X

VETËDEKLARIM

Bazuar në nenin 68¹, pika 3, të ligjit nr. 10019 , datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar) deklaroj, se aktualisht jam deputet i Kuvendit të Shqipërisë dhe:

Përfaqësoj partinë politike “PARTIA E LIRISË”

Jam deputet i pavarur.

DEPUTETI

ERISA PIRO XHIXHO

TIRANE DATË 01.03.2023

¹ Neni 68 Listat mbështetëse të partive politike dhe koalicioneve (Ndryshuar me ligjin nr.74/2012, datë 19.7.2012, zëvendësuar togfjalësh në pikën 3 me ligjin nr. 118/2020, datë 5.10.2020) 1. Listat e kandidatëve për Kuvendin, të paraqitura nga partitë politike, të cilat nuk zotërojnë asnjë mandat në Kuvend, duhet të mbështeten nga jo më pak se 5,000 zgjedhës në shkallë kombëtare. Në rastin e koalicionit zgjedhor listat në tërësi duhet të kenë marrë 35 mbështetjen e jo më pak se 7,000 zgjedhësve në shkallë kombëtare. Bën përjashtim nga ky rregull koalicioni, ku partitë pjesëtare zotërojnë bashkërisht në Kuvend një numër mandatesh jo më të vogël se numri i partive pjesëtare të koalicionit. 2. Kandidatët për organet e njësisë së qeverisjes vendore, të paraqitur nga partitë politike, të cilat nuk zotërojnë asnjë mandat në Kuvend ose në organet e njësisë përkatëse të qeverisjes vendore, duhet të mbështeten nga jo më pak se 1 për qind e zgjedhësve të asaj njësie, por, në çdo rast, jo më shumë se 3,000 dhe jo më pak se 50 zgjedhës. Bën përjashtim nga ky rregull koalicioni, ku partitë pjesëtare zotërojnë bashkërisht në Kuvend një numër mandatesh jo më të vogël se numri i partive pjesëtare të koalicionit, ose kur zotërojnë bashkërisht në këshillin përkatës një numër mandatesh jo më të vogël se numri i partive pjesëtare të koalicionit. 3. Për qëllim të këtij neni, partia politike ose koalicioni paraqet një vërtetim me shkrim, të nënshkruar nga institucioni i Kuvendit apo njësia e qeverisjes vendore, ku vërtetohet zotërimi i mandatit të paktën 6 muaj para përfundimit të mandatit të Kuvendit ose të organit të njësisë së qeverisjes vendore, në bazë të vetëdeklarimit të zotëruesve të mandateve për përkatësinë në partinë politike, në institucionin përkatës.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 777/11 Prot.

Datë 01.03.2023

V È R T E T I M

Bazuar në nenin 68, pika 2 dhe 3, të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, vërtetohet se në bazë të vetëdeklarimit të paraqitur në institucionin e Kuvendit, deputeti Erisa Pirro Xhixho zotërues i mandatit në Kuvend, ka deklaruar përkatësinë në partinë politike “Partia e Lirisë”.

Lëshohet ky vërtetim sipas kërkesës së deputetit të interesuar.

Bashkëlidhur një kopje e vetëdeklarimit të deputetit.

Genc GJONÇAJ
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

LEGJISLATURA X

VETËDEKLARIM

Bazuar në nenin 68¹, pika 3, të ligjit nr. 10019 , datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar) deklaroj, se aktualisht jam deputet i Kuvendit të Shqipërisë dhe:

Përfaqësoj partinë politike “Partia e Lirisë

Jam deputet i pavarur.

DEPUTETI

MONIKA RAMZAN KRYEMADHI

TIRANE 09.03.2023

¹ Neni 68 Listat mbështetëse të partive politike dhe koalicioneve (Ndryshuar me ligjin nr.74/2012, datë 19.7.2012, zëvendësuar togfjalësh në pikën 3 me ligjin nr. 118/2020, datë 5.10.2020) 1. Listat e kandidatëve për Kuvendin, të paraqitura nga partitë politike, të cilat nuk zotërojnë asnjë mandat në Kuvend, duhet të mbështeten nga jo më pak se 5,000 zgjedhës në shkallë kombëtare. Në rastin e koalicionit zgjedhor listat në tërësi duhet të kenë marrë 35 mbështetjen e jo më pak se 7,000 zgjedhësve në shkallë kombëtare. Bën përjashtim nga ky rregull koalicioni, ku partitë pjesëtare zotërojnë bashkërisht në Kuvend një numër mandatesh jo më të vogël se numri i partive pjesëtare të koalicionit. 2. Kandidatët për organet e njësisë së qeverisjes vendore, të paraqitur nga partitë politike, të cilat nuk zotërojnë asnjë mandat në Kuvend ose në organet e njësisë përkatëse të qeverisjes vendore, duhet të mbështeten nga jo më pak se 1 për qind e zgjedhësve të asaj njësie, por, në çdo rast, jo më shumë se 3,000 dhe jo më pak se 50 zgjedhës. Bën përjashtim nga ky rregull koalicioni, ku partitë pjesëtare zotërojnë bashkërisht në Kuvend një numër mandatesh jo më të vogël se numri i partive pjesëtare të koalicionit, ose kur zotërojnë bashkërisht në këshillin përkatës një numër mandatesh jo më të vogël se numri i partive pjesëtare të koalicionit. 3. Për qëllim të këtij neni, partia politike ose koalicioni paraqet një vërtetim me shkrim, të nënshkruar nga institucioni i Kuvendit apo njësia e qeverisjes vendore, ku vërtetohet zotërimi i mandatit të paktën 6 muaj para përfundimit të mandatit të Kuvendit ose të organit të njësisë së qeverisjes vendore, në bazë të vetëdeklarimit të zotëruesve të mandateve për përkatësinë në partinë politike, në institucionin përkatës.





Nr. 142 Prot.

Tiranë, më 15.03.2023

A U T O R I Z I M

Autorizoj z. Endrit Braimllari, Nënkryetar i partisë "Partia e Lirisë" (PL), të përfaqësojë subjektin zgjedhor "Partia e Lirisë" (PL), apo koalicionin ku ajo bën pjesë në marrëdhënie me KQZ-në apo të tretët (organet shtetërore si dhe Kolegjin Zgjedhor, apo organe të tjera gjyqësore).

KRYETARI
ILIR METAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 946/Prot.

Datë 15.03.2023

V È R T E T I M

Bazuar në nenin 68, pika 2 dhe 3, të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, vërtetohet se në bazë të vetëdeklarimit të paraqitur në institucionin e Kuvendit, deputeti Monika Ramazan Kryemadhi zotërues i mandatit në Kuvend, ka deklaruar përkatësinë në parti të politike “Partia e Lirisë”.

Lëshohet ky vërtetim sipas kërkesës së deputetit të interesuar.

Bashkëlidhur një kopje e vetëdeklarimit të deputetit.

Genc GJONÇAJ
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

